



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

# R A P O R T

MBI

VEPRIMTARINË E AKEP  
PËR VITIN 2013

Tiranë, Mars 2014

## PËRMBAJTJA

Nr.	Emërtimi	Nr. Faqes
1	Hyrje	2-8
2	Raporti i punës së AKEP për vitin 2013	9
3	Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm	10-14
4	Veprimtaria për mbikëqyrjen e tregjeve, tarifave dhe vendosjen e masave rregullatore	15-41
5	Veprimtaria për administrimin e spektrit të frekuencave, numeracionit, vlerësimin të cilësisë dhe administrimit domain.al	42-49
6	Veprimtaria e inspektimit dhe monitorimit të spektrit të frekuencave si dhe masat administrative	50-52
7	Veprimtaria për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve	53-57
8	Aspekte të tjera të veprimtarisë	58-60
9	Programi vjetor i punës për vitin në vazhdim	61-62
10	Raporti për statusin e shërbimit universal	63-64
11	Raportimi për realizimin e treguesve financiarë vjetor	65-70

## HJRJE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), është organi rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë postare, të përcaktuar nga legjislacioni përkatës material si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Raporti i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013 i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 9 të ligjit nr. 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “AKEP-i është përgjegjës për punën e tij përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” dhe “Në përfundim të çdo viti, AKEP-i paraqet në Kuvend, brenda katër muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës.

Raporti në përputhje me përcaktimet ligjore për këtë qëllim përmban në mënyrë të veçantë:

- Raportin e punës së AKEP për vitin 2013 ;
- Programin vjetor të punës për vitin 2014;
- Raportin për statusin e shërbimit universal; dhe
- Raportimin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të AKEP.

Baza ligjore mbi të cilën AKEP-i mbështet veprimtarinë e tij përbëhet nga:

- ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji 9918/2008**);
- ligji nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për Shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji 8530/1999**);
- ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (**ligji 97/2013**);
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 322, datë 5.5.2010 “ Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**VKM 322/2010**);
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 625, datë 24.07.2013 “Për miratimin e Dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Shërbimeve Postare në Republikën e Shqipërisë” (**VKM 625/2013**);
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (**VKM 466/2013**);
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
- Kuadri rregullator i përbërë nga aktet normative administrative (Rregullore) të publikuara në faqen elektronike [www.akep.al](http://www.akep.al)

Për kryerjen sa më mirë të rolit dhe funksioneve të AKEP-it si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe fushës së shërbimit postar, ushtrimi i veprimtarisë është udhëhequr nga parimi i zbatimit sa më rigoroz të ligjshmërisë duke i ushtruar kompetencat në përputhje të plotë me sanksionet ligjore, si dhe duke i zbatuar të drejtat dhe detyrimet institucionale të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator të fushës, për realizimin me sukses të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në politikat e Këshillit të Ministrave për zhvillimin sektorial, Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së

Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2012” si dhe Raportit të Progresit për Shqipërinë të KE, për vitin 2012.

Kuvendi nëpërmjet Rezolutës (R. 64/2 Prot., datë 06/05/2013) “Për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP për vitin 2012”, kërkoi nga AKEP-i për vitin 2013:

1. Të angazhohet vazhdimisht në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për rritjen e fleksibilitetit, efektivitetit dhe transparencës së ofrimit të shërbimeve të tij;
2. Të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për të garantuar kushtet e një konkurrence të ndershme në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare;
3. Të angazhohet në implementimin e shërbimit universal bazuar në zgjidhjet e tregut, parimin e proporcionalitetit, reflektimin e statusit kombëtar të sektorit, si dhe sigurinë ligjore dhe korrektësinë procedurale;
4. Të angazhohet vazhdimisht në uljen e mëtejshme të tarifave të shërbimeve të ofruara në tregun e komunikimeve elektronike;
5. Të vazhdojë të angazhohet në administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave;
6. Të vazhdojë të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse;
7. Të vazhdojë të angazhohet në plotësimin e kuadrit rregullator për funksionimin e tregut postar;
8. Të angazhohet në kryerjen e analizave të tregut në ofrimin e shërbimeve linja me qira dhe aksesin *broadband*;
9. Të vazhdojë të angazhohet në plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të ndryshimeve të ndodhura në legjislacionin parësor për komunikimet elektronike;
10. Të vazhdojë të angazhohet në miratimin dhe implementimin e rregullave për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (AS/CA-Account Separation/Cost Accounting) për operatorët FNT;
11. Të angazhohet në miratimin dhe implementimin e ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit.

Plotësimi i kërkesave të Kuvendit nëpërmjet Rezolutës, është konsideruar si një program pune dhe ka orientuar veprimtarinë e AKEP-it për vitin 2013.

Objektivat kryesorë të veprimtarisë në aspektin rregullator kanë qenë:

- sigurimi i një mjedisi biznesi të qartë dhe të parashikueshëm për funksionimin e sipërmarrësve dhe investimeve të rëndësishme;
- krijimi kushtve për zbatimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në tërë territorin e Shqipërisë, nëpërmjet nxitjes së përdorimit racional dhe eficient të burimeve të kufizuara (frekuencave dhe numeracionit);
- nxitja e konkurrencës dhe parandalimit të deformimit të konkurrencës në treg ndërmjet operatorëve;
- zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimit të qëndrueshëm e të vazhdueshëm të mbrojtjes së interesave të përdoruesve.

Për të garantuar ushtrimin e funksioneve në përputhje me objektivat rregullatore dhe parimet e përgjithëshme si organ administrativ, plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator është konsideruar si një objekt shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP-it.

Në zbatim të kompetencës ligjore të nxjerrjes së rregulloreve në zbatim të ligjit, akteve të tjera ligjore dhe nën ligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar, gjatë vitit

2013 janë hartuar dhe miratuar duke zbatuar rigorizisht procedurat e këshimit publik, një sërë aktesh normative rregullatore, ndër të cilat si më kryesorët mund të përmendim:

- “Rregulla dhe udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”;
- “Rregulla për “Termet e Përgjithëshme të Kontratës së Pajtimimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”;
- Rregullore për “Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”;
- Rregullore për “Dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, etj.

Një ndër aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së AKEP përbën veprimtaria e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve dhe tarifave.

Për kryerjen e analizës së tregjeve përkatëse mbi bazën e një kuadri rregullator në përputhje të plotë me parashikimet ligjore në fuqi, u kryen ndryshimet e nevojshme në Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”. Si rezultat i kësaj ndërhyrje legjislative, kuadri rregullator në fuqi reflekton një qasje të plotë me ndarjen e tregjeve përkatëse sipas listës në përputhje me rekomandimin e KE, të datës 17 Dhjetor 2007 ((2007/879/EC).

Në drejtim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe kuadrit rregullator të veprimtarisë së sipërmarrësve lidhur me aspektet e konkurrencës, për sa parashikon ligji nr. 9918/2008, në kuadër të ushtrimit të kompetencës lidhur me përcaktimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme, në përputhje me afatet e zbatimit të analizës së tregjeve, janë kryer analiza dhe hedhur në treg për konsultim publik dokumentat rregullatore:

- “Analiza e tregut të telefonisë fikse”;
- “Analiza e tregut me shumicë të aksesit në broadband dhe LLU”;
- “Analiza e tregut të Linjave me qira”;
- “Analiza e tregut me shumicë të terminimit të SMS-ve në telefoninë e lëvizëshme.

Nga të dhënat që administron AKEP-i rezulton se shërbimet e ofruara nga rrjetet celulare patën rritje në 2013, ku rritje të ndjeshme kishin shërbimet 3G. Numri i përdoruesve aktiv të telefonisë celulare në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milion në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, pati reduktim me 6%, duke arritur në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2013 ishte 130% sipas përdoruesve aktivë dhe 187% sipas kartave SIM. Numri i pajtimtarëve celularë që përdorin shërbimet 3G të aksesit broadband në 2013 arriti në rreth 1.2 milion, duke u rritur me 90%: numri pajtimtarëve me akses broadband 3G me karta USB/modem u rrit me 101 % ndërsa numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G nga aparatet celulare u rrit me 88%

Në shërbimet e ofrura nga rrjetet fikse, aksesit broadband në internet pati rritje të ndjeshme (me 14%), ndërsa numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie me 10%. Siç është theksuar edhe në raportin vjetor 2012, evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore në drejtim të kërkesës për akses në Internet, kanë bërë që shtytësi kryesor për

zhvillimin e rrjeteve fikse të jetë aksesit broadband në internet. Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në 2013 u rrit me 14% në krahasim me 2012, dhe vihet re se të gjithë operatorët kryesorë kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband.

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Norma e penetrimit me të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje.

Rrjetet fikse kanë pasur zgjerim në dy pjesët kryesore, rrjet bazë (core) dhe akses duke rritur proporcionin dhe kapacitetet e fibrave optike, dhe se tendenca është drejt rrjeteve IP dhe shërbimeve që mundësojnë këto rrjete (si aksesit broadband) por që përfshijnë dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve telefonike, nëpërmjet platformave të ndryshme VoIP, të cilat kanë filluar të kenë përdorim të lartë jo vetëm në rrjete fikse por edhe në rrjete celulare.

Tarifat e shërbimeve celulare kanë vazhduar tendencën e reduktimit të tyre edhe në vitin 2013. Nga krahasimi i tarifave celulare sipas shportave OECD, rezulton se reduktime më të ndjeshme janë kryer në programet tarifore për shportat e konsumit mesatar (reduktim mesatarisht me 35%) dhe konsumit të lartë (reduktim mesatarisht me 28%). Niveli mesatar i shpenzimeve për shportat OECD rezulton të jetë në nivele afërsisht sa niveli mesatar në vendet e BE dhe rajonit për konsum mesatar dhe të lartë dhe më të ulëta se këto nivele për konsum të ulët.

Tregues të tjerë të shpenzimeve të përdoruesve celularë përfshijnë treguesit e ARPU<sup>1</sup> dhe ARPM<sup>2</sup>, që masin të ardhurën mesatare të operatorëve (shpenzimin mesatar të përdoruesve) për përdorues dhe minutë. Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPM sic mund të vihet re nga grafiku më poshtë për vitin 2012 ishte ndër më të ulët në rajon dhe 2-3 herë më i ulët se mestarja në vendet e BE.

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar tendenca e viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse për promovim të paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (*bundles of minutes*) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (*bundles of services*). Vihet re se këto lloj paketash kanë filluar të ofrohen edhe për segmentin e pajtimtarëve Biznes krahas segmentit familjarë, nga Albtelecom dhe operatorët kryesorë alternativë.

Shërbimi i aksesit broadband në 2013 pati zhvillime pozitive jo vetem në terma të rritjes së numrit të pajtimtarëve, por dhe në terma të reduktimit të tarifave dhe rritjes së shpejtësisë së aksesit broadband. Nga krahasimet me vendet e rajonit, vihet re se tarifat në Shqipëri janë në nivelin mesatar të vendeve të rajonit, për operatorin incumbent (Albtelecom) dhe operatorët alternativë.

Niveli i tarifave të aksesit broadband të Albtelecom për paketat më të përdorura 2-4Mbps është reduktuar me 17-33%, ndërsa për Abcom (operatori më i madh alternativ) reduktimi është në 20-28%. Reduktime të ndjeshme kanë pësuar edhe tarifat e aksesit internet 3G, me karta USB dhe aparate celulare, të cilat kanë çuar në rritje të ndjeshme të numrit të këtyre pajtimtarëve dhe trafikut data në rrjetet celulare.

Shpejtësia më e përdorur e aksesit në internet nga rrjete fikse është rritur nga 2-4 Mbps në 2012 në 4-8 Mbps në 2013. Në 2013 52% e pajtimtarëve ADSL të Albtelecom kishin akses në internet me shpejtësi mbi 4 Mbps.

<sup>1</sup> ARPU (Average Revenue Per Users-E Ardhura Mesatare Për Përdorues)

<sup>2</sup> ARPM (Average Revenue Per Minute-E Ardhura Mesatare Për Minutë)

Në kuadër të masave për sigurimin e shërbimit universal, si një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së ushtruar në këtë drejtim vlen të përmendet miratimi i Dokumentit për “Statusin aktual dhe Plani kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri”.

Në drejtim të ushtrimit të kompetencës për administrimin e spektrit të radiofrekuencave në funksion të nxitjes së konkurrencës, veprimtaria është orientuar drejt zbatimit të parashikimeve të reja ligjore sipas parimit të neutralitetit teknologjik të transpozuar nga Direktiva KE/2009 për këtë qëllim, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

Në këtë kuadër një ndër aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë është miratimi i Dokumentit dhe fillimi në muajin tetor 2013 i procedurës për këshillim publik me objekt “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz dhe 2110 - 2170MHz, brezi IMT”, bazuar tashmë në rregullimet e reja ligjore sipas ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe të politikave rregullatore të zbatuar në nivel evropian nën WAPECS (Politikat për Aksesin Wireless për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike “Wireless Access Policy for Electronic Communications Services”) të përcaktuara në Vendimet përkatëse të KE-së dhe Vendimet e ECC të zbatueshme për brezat mobile përkatës.

Pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së AKEP-it përbën edhe administrimi i numeracionit, emrave dhe adresave sipas përcaktimeve ligjore dhe Planit Kombëtar të Numeracionit (PKN) të nxjerrë dhe miratuar nga vetë AKEP-i.

AKEP-i gjatë vitit 2013 ndërmori iniciativën ligjore dhe realizoi ndërhyrjet e nevojshme në Planin Kombëtar të Numeracionit, duke i shërbyer në këtë mënyrë jo vetëm mirëadministrimit të këtij burimi të kufizuar kombëtar por edhe përdoruesve në drejtim të thjeshtëzimit të numerformimit për telefoninë fikse.

Bazuar në të dhënat e administruara nga sistemi Web-Gis (Projekti ATLAS) i informacioneve hapësinore dhe jo hapësinore të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike rezultojnë rreth 3,235,589 m kabëll fibër optike e shtrirë në të gjithë territorin e vendit.

Vëmendje e veçantë është treguar edhe në drejtim të mirëfunksionimit të veprimtarisë së dhënies së autorizimit nga AKEP-i për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të procesit të regjistrimit të Njoftimit për fillimin, ndryshimin dhe mbylljen e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike, tashmë AKEP-i administron një regjistër të përditësuar të sipërmarrësve në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente me të gjitha të dhënat e parashikuara ligjërisht për tu regjistruar. Në veçanti, AKEP tashmë ka informacion të detajuar mbi sipërmarrësit se ku shtrihet rrjeti i tyre, si ofrohet rrjeti i aksesit dhe rrjeti i transportit, mënyrat e ofrimit të shërbimeve tek pajtimtarët, protokollet e komunikimeve që përdorin sipërmarrësit, llojet e përçuesve të sinjalit (kablo bakri, fibra optike, antena, etj), mënyrat e marrjes së aksesit internet nga sipërmarrësit, kapacitetet aktuale, operatorët e segmenteve hapësinore (për shërbimet VSAT), etj. Gjithashtu në regjistrin e sipërmarrësve tashmë të gjitha adresat postare, adresat e-mail dhe numrat e kontakteve janë të përditësuara dhe funksionale, pasi vetë moduli i aplikimeve

online kërkon adresa e-mail funksionale në mënyrë që sipërmarrësi të marrë të dhënat për login “përdoruesin, fjalëkalimin, kodin e konfirmimit”, pranimin apo kthimin për rishikim të aplikimit, etj.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" u morën masat e duhura rregullatore për kryerjen e regjistrimit të njoftimit të operatorëve që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike përditësuar deri më datë 31.12.2013, janë të regjistruar gjithësej 74 sipërmarrës që ofrojnë rrjete publike tokësore fikse/ TV Kabllor.

Në regjistrin e sipërmarrësve të regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike përditësuar, deri më 31.12.2013 rezultojnë të regjistruar në total 240 sipërmarrës, nga të cilët 93 të regjistruar gjatë vitit 2013.

Pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së AKEP-it përbën edhe administrimi i domain cc.TLD.AL si dhe nëndomainet e tij. Gjatë vitit 2013 u realizua kalimi nga sistemi Regjistër-Regjistruues për AKEP në Regjistër AKEP dhe regjistruues i liberalizuar. Ky proces u konkretizua me çertifikimin e 5 subjekteve si regjistruues. Ka vazhduar procesi i regjistrimit të domain-eve nga AKEP në zonen .al duke plotësuar funksionin e regjistruarit. Numri i domain-eve të regjistruar për vitin 2013 është **3320** dhe kemi një numër total prej **12 888** domain-e.

Performanca e treguesve ekonomik – financiarë të AKEP – it për vitin 2013 është:

<b>Nr.R en</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Programi</b>	<b>Realizimi</b>
<b>I</b>	<b>Të ardhurat gjithsej:</b>	<b>273,300,000</b>	<b>279,566,368</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>273,300,000</b>	<b>193,771,751</b>
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	75,500,000	64,780,771
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,500,000	8,862,985
3	Shpenzimet për materiale	5,800,000	4,215,314
4	Shpenzimet për shërbime	48,000,000	36,089,731
5	Shpenzimet për Investime	133,500,000	<b>79,808,919</b>
<b>III</b>	<b>Tarifa e Shërbimit të radiokomunikacionit</b>		<b>303,485,096</b>
1	Arkëtuar dhe Transferuar në Buxhetin e Shtetit		<b>303,485,096</b>

Veprimtaria vendimmarrëse e Këshillit Drejtues në përmbushje të kompetencave dhe detyrimeve ligjore ka siguruar përmbushjen e objektivave të planifikuara në Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2013, si dhe është kryer në përputhje të plotë me procedurën e parashikuar në ligjin 9918/2008 dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Gjatë vitit 2013 janë kryer 25 (njëzet e pesë) mbledhje të Këshillit Drejtues, si dhe janë marrë 49 (dyzet e nëntë) vendime të rëndësishme të karakterit rregullator dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ankesave të ardhura nga sipërmarrësit, përveç vendimeve të karakterit të brendshëm administrative dhe atyre për miratimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit deri në hyrjen në fuqi të rregulloreve të reja dhënieve e Autorizimeve Individuale nëpërmjet procedurës së aplikimit *on-line*.

Veprimtaria ekzekutive dhe ajo administrative e drejtuar nga Kryetari i Këshillit Drejtues edhe për vitin 2013 është kryer në kushtet e mungesës së kapaciteteve të duhura të burimeve



njerëzore, përmirësimi i të cilave përbën një kërkesë konstante dhe të vazhdueshme të çdo Raporti Progresi për Shqipërinë të KE, si dhe mos miratimit të strukturës dhe organikës së re, propozuar Kuvendit për miratim që në vitin 2010. Struktura dhe organika me të cilën AKEP-i ushtroi veprimtarinë gjatë vitit 2013, janë miratuar nga Kuvendi me vendim nr. 97, datë 30. 04. 2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ERT”, ndryshuar me Vendimin nr. 178, datë 14. 04. 2008 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 97, datë 30. 04. 2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ERT” mbi bazën e ligjit nr. 8618, datë 14. 06. 2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji 8618/2000**), i shfuqizuar me ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo strukturë nuk i përgjigjet fushës së veprimtarisë së AKEP-it lidhur me shërbimin postar, i cili është vendosur në fushën e veprimtarisë së institucionit me ligjin 9918/2008, si dhe shumë nevojave të tjera organizative dhe organike në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave rregullatore të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, në drejtim të funksionalitetit ligjor, duke patur parasysh këtu jo vetëm nevojën e një transpozimi të legjislacionit material vendor me atë European për një qasje sa më të plotë të përputhshmërisë formale të tyre, si në fushën e komunikimeve elektronike ashtu dhe në atë të shërbimit postar, por edhe atë të garantimit të një zbatimi real dhe eficient të tij , konstatojmë dhe ngremë përpara Kuvendit nevojën e ndryshimeve ligjore, kryesisht në atë të procedurës për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezat e kufizuar, si dhe të dispozitave që garantojnë lirinë dhe funksionimin e pavarur të institucionit lidhur me miratimin e strukturës dhe derdhjen e tepricave të të ardhurave dhe shpenzimeve në Buxhetin e Shtetit Në këtë aspekt ligji 9919/2008 për komunikimet elektronike përmban ende disa dispozita që bien ndesh me frymën dhe përmbajtjen e Direktivave të KE për fushën e komunikimeve elektronike.

**I**

**RAPORTI I PUNËS SË AKEP PËR VITIN 2013**

## **1. AUTORIZIMI PËR TË OFRUAR RRJETE DHE SHËRBIME TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM:**

Sipas ligjit 9918/2008 autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:

- a) Përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuar;
- b) Pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

Gjithashtu ligji 9918/2008 përcakton kompetencën e AKEP-it për regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit. Gjithashtu me ndryshimet e pësuar ky ligj me ligjin 102/2012, AKEP-i disponon kompetencën e përcaktimit të rregullave për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare, si dhe rregullave dhe kërkesave teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore.

Kjo veprimtari, për shkak të mungesës së miratimit nga Kuvendi të strukturës dhe organikës së AKEP-it në funksion të këtyre kompetencave ligjore, vazhdon dhe mbulohet nga Drejtoria e Licencimit, e organizuar ende sipas funksioneve të parashikuara në ligjin e shfuqizuar 8618/2000.

Autorizimi i hyrjes në treg të subjekteve për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2012, është bërë bazuar në dispozitat e rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1774 datë 02.02.2012, shoqëruar kjo me aplikacionin përkatës *on-line*.

Aplikimi on-line bazuar në kushtet e anekseve të rregullores, ka bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar dhe të nevojshëm mbi:

- rrjetet/shërbimet që ofron sipërmarrësi;
- statusin ligjor, shoqëruar me ekstraktin e QKR-së;
- teknologjinë e përdorur dhe mediumet e komunikimit;
- kushtet e ofrimit të aksesit dhe shërbimit pajtimtarit-kontrata tip;

Aplikimi on-line për autorizim të hyrjes në tregun e komunikimeve elektronike, veç të tjerave, saktëson detajet e kontaktit të sipërmarrësit pasi vetë moduli i aplikimit kërkon adresë e-mail funksionale në mënyrë që sipërmarrësi të marrë të dhënat për login “përdoruesin, fjalëkalimin, kodin e konfirmimit”, pranimin apo kthimin për rishikim të aplikimit.

Me zbatimin e kësaj rregulloreje “Regjistri i Sipërmarrësve” është më i detajuar dhe i organizuar, duke lehtësuar identifikimin e sipërmarrësit dhe rrjetet/shërbimet e ofruara prej tij.

Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit dhe Regjistri i Sipërmarrësve përmbajnë të njëjtat të dhëna për rrjetin dhe shërbimet që ka deklaruar sipërmarrësi. Gjithashtu sipërmarrësit kanë të njëjtin numër identifikimi të aplikimit si në Çertifikatë ashtu dhe në Regjistrë.

Gjatë procesit të aplikimeve *online* vlen të cilësohet fakti që sipërmarrësit e rinj të cilët kanë aplikuar për herë të parë, kanë përfunduar me sukses aplikimin dhe janë pajisur me Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit. Kjo tregon se mënyra e aplikimit online është e lehtë dhe e asimilueshme edhe nga sipërmarrës të rinj.

Përveç guidës së aplikimit të publikuar në faqen *web* të AKEP dhe manualeve të përdorimit që ndodhen në modulën e aplikimeve online, Drejtoria e Licencimit ju ka ardhur në ndihmë sipërmarrësve me udhëzime të detajuara për kryerjen e procesit të aplikimeve online.

Në zbatim të Urdhërit nr. 950, datë 22.02.2013 “Për caktimin e administratorit të Regjistrimit të Sipërmarrësve për Ofrimin e Rrjeteve dhe Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike dhe Regjistrimit të Licencave të Përgjithshme të Operatorëve Publikë dhe Ofruesve të Shërbimeve Postare”, janë përgatitur informacione periodike mujore për sipërmarrësit që kanë njoftuar online për fillim/ndryshim/mbyllje aktiviteti për rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimeve postare. Mbetet detyrë e vazhdueshme për sipërmarrësit e regjistruar mbi verifikimin ndryshimeve nëse kanë ndodhur në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar në QKR dhe vijimi procedurave për përditësimin e ndryshimeve të tyre. Gjithashtu më tepër vlerësim kërkon detyra mbi njoftimin e sipërmarrësve të cilët nuk kanë ofruar rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike deri në datën që kanë deklaruar në njoftimin e regjistrimit.

Në zbatim të Urdhërit nr. 957, datë 18.03.2013 “Për caktimin e administratorit të Regjistrimit të Informacionit Periodik të Raportuar nga Sipërmarrësit”, Drejtoria e Licencimit ka plotësuar dhe përditësuar online të dhënat sipas regjistrimit të sipërmarrësve, që kanë njoftuar për Fillim/Ndryshim/Mbyllje të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike sipas regjistrimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Me qëllim kalimin në procedurë aplikimi online edhe të procesit të zbatuar nga subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë/autorizim/çertifikatë sipas akteve normative të nxjerra nga AKEP-i:

- a. *Rregullore Nr.7, datë 23.12.2008, “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes””.*
- b. *Rregullore Nr.6, datë 23.12.2008, “Për dhënien e “Certifikatës Operatorit Radiodetar””.*
- c. *Rregullore datë 23.12.2008, “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të avionit””.*
- d. *Rregullore Nr.5, datë 23.12.2008, “Për dhënien e Autorizimit “Për stacionet radio bregdetare””.*
- e. *Rregullore Nr.14, datë 13.04.2010, “Për dhënien e licencës “Autoriteti i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””.*
- f. *Rregullore datë 13.04.2010, “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë””.*
- g. *Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011, “Për dhënien e Licencës së Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”.*

u krye ndërhyrje legjislative në këto akte duke parashikuar dispozita të cilat rregullojnë zbatimin e procedurës së aplikimit online. Në këtë mënyrë u arrit që të kryhen të gjitha aplikimet për licencë/autorizim/çertifikatë nëpërmjet modulit të aplikimeve online.

Gjatë vitit 2013 përveç regjistrimit të sipërmarrësve janë përditësuar dhe regjistrat e shërbimeve të tjera me të dhënat e kërkuara sipas ligjit nr. 9918 dhe akteve rregullatore përkatëse, duke kryer periodikisht publikimin e tyre në “*web site*” të AKEP.

Sipas rregullores “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me VKD të AKEP Nr.1222, datë 13.04.2010, e ndryshuar, është vijuar procesi për ndjekjen e procedurave për pajisje me licencë dhe çertifikatë për radioamatorë, mbajtja e korrespondencës me aplikantët dhe zbardhja e licencave të përkohshme për radioamatorët e huaj.

Në zbatim të kërkesave të Rregullores nr. 5, datë 23.12.2008 “Për dhënien e Autorizimit për Stacionet Radiobregdetare” e ndryshuar, është pajisur Drejtoria e Përgjithshme Detare me 5 Autorizime të Stacioneve Radiobregdetare për përdorim nga Kapiteneritë e Porteve:

a.	Kapiteneria e Portit Durrës	Regjistruar	datë 08.04.2013
b.	Kapiteneria e Portit Shëngjin	Regjistruar	datë 08.04.2013
c.	Kapiteneria e Portit Vlorë	Regjistruar	datë 08.04.2013
d.	Kapiteneria e Portit Sarandë	Regjistruar	datë 08.04.2013
e.	Kapiteneria e Portit Himarë	Regjistruar	datë 08.04.2013

Deri në fund të vitit 2013, sipas procedurës së trajtimit të kërkesave për shërbimet e lëvizëshme ajrore dhe detare, janë të regjistruar këto licenca/autorizime dhe çertifikata.

Sipas kërkesave të parashikuara në rregulloret për shërbimet e lëvizëshme ajrore dhe detare, janë evidentur në regjistra te veçantë të dhënat për subjektet e licensuara për stacionet radio të anijes, avionit, stacionet radio bregdetare, për autoritetin e llogarive detare dhe kodin AAIC dhe personat e pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar, të cilat janë publikuar në faqen web të AKEP.

AKEP disponon të dhënat që mund të kërkohen nga ITU dhe CEPT, për stacionet Radio të Anijes të licencuara nga AKEP dhe për stacionet Radio Bregdetare të autorizuara nga AKEP për veprimtarinë e tyre. Të dhënat e stacioneve radio bregdetare të kapitenerive të porteve janë dërguar dhe publikur nga ITU në muajin Prill 2013.


Me poshtë paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike sipërmarrësit dhe autorizime /licenca/ çertifikata të regjistruara në AKEP deri në fund të vitit 2013.

**Tabela 1: Sipërmarrësit e regjistruar në AKEP gjithsej deri në fund të vitit 2013:**

Nr.	Sipërmarrës	Aplikime të konfirmuara		Të regjistruar		Të çregjistruar	
		2012	2013	2012	2013	2012	2013
1	Sipërmarrës të regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike	160	253	157	240	3	13

**Shënim:** Nga (240) sipërmarrës të regjistruar, (74) janë të regjistruar për rrjet TV Kabllor. Shifrat për vitin 2013 përfshijnë dhe shifrat për vitin 2012.

Të dhënat e tabelës 1 për sipërmarrësit e regjistruar në vitet 2012 dhe 2013, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



**Tabela 2: Autorizime/Licenca/Certifikata të regjistruara në AKEP gjithsej deri në fund të vitit 2013:**

Nr.	Autorizime/Licenca/Certifikata	Të regjistruar
1	Licenca të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare	12
2	Licenca për autoritetin e llogarive detare dhe kodin AAIC	1
3	Licenca për stacionet radio të anijes	19
4	Licenca për stacionet radio të avionit	4
5	Çertifikata për operatorët radiodetar	58
6	Autorizime për stacionet radio bregdetare.	5
	Autorizim për stacionet radiobregdetar kombëtar për anijet e peshkimit.	1
7	Çertifikata radioamatore shqiptare	11
8	Licenca radioamatore shqiptare	13
9	Licenca radioamatore për të huaj	9

Në tabelën e mësipërme janë përfshirë Licenca/Autorizime/Çertifikata të cilat sipas vlefshmërisë së tyre janë regjistruar para vitit 2013, por në kohëzgjatjen e tyre përfshihet dhe viti 2013.

*Shënim: Në vitin 2013 është çregjistruar 1 (një) ofruer i shërbimeve postare.*

**Tabela e Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftuara dhe regjistruara në AKEP nga sipërmarrësit gjithsej në periudhën 02.02.2012 deri 31.12.2013 dhe në vitin 2013:**

Nr.	Shërbime publike të komunikimeve elektronike të njoftuara nga sipërmarrësit	Sipërmarrës të regjistruar që kanë njoftuar shërbimet	
		Gjithsej nga 02.02.2012 deri 31.12.2013	Viti 2013
1	Telefoni e lëvizshme	4	-
2	Telefoni fikse	79	7
3	Telefoni me anë të kartave të parapaguara.	7	3
4	Internet	131	19
5	Transmetim të dhëna	58	6
6	Shërbim me vlerë të shtuar	31	5
7	Linja me qera	17	2

Me Vendimin Nr. 2231, datë 28.12.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP është miratuar Rregullore nr. 28, datë 28.12.2012 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”.

Në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.28, datë 28.12.2012 “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, Operatori publik postar dhe Ofruesit e shërbimeve postare, kanë dërguar online të dhënat satatistikore dhe finaciare për vitin 2012 dhe deri në fund të vitit 2013 të dhënat satatistikore për 6 mujorin e parë 2013. Të dhënat e 6 mujorit të dytë paraqiten nga Operatori publik postar dhe Ofruesit e shërbimeve postare brenda 4 mujorit të parë të vitit 2014.

Sipas të dhënave në tabelën përmbledhëse treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë deri në periudhën 31 Mars të vitit 2013 rezultojnë me këta tregues kryesorë:

- Objekte postare gjithsej 22.591.806 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **8 objekte / banorë.**
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun 839 në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **3.363 banorë / zyrë.**
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun 839 në raport me sipërfaqen 28.748 Km<sup>2</sup> janë: **34.2 Km<sup>2</sup> / zyrë.**

Të dhënat e plota për vitin 2013, duke patur parasysh përcaktimin e nenit 8 të Rregullores Nr.28, datë 28.12.2012 “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”, sipas të cilit këto të dhëna duhet të dërgohen në AKEP brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, do të bëhen publike pas administrimit dhe përpunimit të tyre në periudhën në vijim.

## **2. VEPRIMTARIA PËR MBIKËQYRJEN E TREGJEVE, TARIFAVE DHE VENDOSJEN E MASAVE RREGULLATORE:**

Një ndër veprimtaritë rregullatore më të rëndësishme të AKEP-it është rregullimi konkurrencës në treg, në zbatim të kompetencave ligjore. Kjo veprimtari kryesisht ushtrohet nëpërmjet:

- analizës së tregjeve përkatëse të parashikuara në ligjin material 9918/2008 dhe rregullores nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut” dhe përcaktimit të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg;
- rregullimit të aksesit dhe interkoneksionit midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin nr. 9918/2008, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe siguron që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme.
- Miratimit të ofertës referencë për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si dhe ofertës referencë për akses të hapur në rrjetin lokal të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit, me aktet nënligjore, si dhe të orientuara në kosto;
- Mbikëqyrjes së respektimit të kërkesave të ligjit për tarifën e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të ligjit 9918/2008,

dhe mbulohet nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik.

### **1. Panorama e përgjithshme e tregut të komunikimeve elektronike**

Gjatë vitit 2013 sektori i komunikimeve elektronike ka pasur rritje të përdorimit të shërbimeve të rrjeteve celulare (telefoni dhe internet 3G) dhe shërbimeve të aksesit broadband nga rrjete fikse, ndërsa ka pasur ulje të përdorimit të telefonisë fikse. Këto tendenca janë të ngjashme me tendencat e viteve të fundit, ku përdorimi i telefonisë fikse ka qënë në rënie duke u zëvendësuar me telefoninë celulare, dhe aksesit broadband ka pasur rritje në të dy segmentet: nga rrjete fikse dhe rrjete celulare.

Shërbimet e ofrura nga rrjetet celulare patën rritje në 2013, ku rritje të ndjeshme kishin shërbimet 3G. Numri i përdoruesve aktiv të telefonisë celulare (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milion në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, pati reduktim me 6%, duke arritur në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2013 ishte 130% sipas përdoruesve aktivë dhe 187% sipas kartave SIM. Numri i pajtimtarëve celularë që përdorin shërbimet 3G të aksesit broadband në 2013 arriti në rreth 1.2 milion, duke u rritur me 90%: numri pajtimtarëve me akses broadband 3G me karta USB/modem u rrit me 101 % ndërsa numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G nga aparatet celulare u rrit me 88%


Në shërbimet e ofrura nga rrjetet fikse, aksesit broadband në Internet kishte rritje të ndjeshme (me 14%), ndërsa numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie me 10%. Rënia e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse ka ardhur kryesisht për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të Albtelecom si dhe nga ndryshimi në të dhënat e raportuara nga operatori më i madh alternativ Abcom, i cili ka raportuar një



reduktim me rreth 20 mijë pajtimtarë. Ky reduktim nga Abcom vjen për shkak të mënyrës së matjes prej tij të numrit të pajtimtarëve telefonikë, duke raportuar vetëm ata pajtimtarë që përdorin dhe paguajnë për shërbim telefonik<sup>3</sup>. Sic është theksuar edhe në raportin vjetor 2012, evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore në drejtim të kërkesës për akses në Internet, kanë bërë që shtytësi kryesor për zhvillimin e rrjeteve fikse të jete aksesit broadband në Internet. Numri pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në 2013 u rrit me 14% në krahasim me 2012, dhe vihet re se të gjithë operatorët kryesorë kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband.


Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Norma e penetrimit me të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje. Dy figurat e mëposhtëme paraqesin ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare (përdorues aktivë) dhe telefonisë fikse në raport me aksesin broadband me rrjete celulare dhe rrjete fikse. Figurat tregojnë qartë se normat e rritjes së aksesit broadband në të dy llojet e rrjeteve janë më të larta se të telefonisë.

**Figura 1: Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë celulare dhe aksesit broadband 3G**



**Figura 2: Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë fikse dhe aksesit broadband fiks**

<sup>3</sup> Abcom është një operator kabllor dhe shërbimi telefonik ofrohet bashkë me shërbimin e internetit. Për vitet e mëparshme numri i pajtimtarëve telefonikë raportohej i barabartë me ata të Internetit. Duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, Abcom konsideron si pajtimtarë telefonikë vetëm ata pajtimtarë që e përdorin apo paguajnë për shërbim telefonik.



Në figurën e mësipërme duhet të kemi parasysh se rrjetet fikse kanë pasur zgjerim në dy pjesët kryesore, rrjet bazë (core) dhe akses, dhe se tendenca është drejt rrjeteve IP dhe shërbimeve që mundësojnë këto rrjete (si akses broadband) por që përfshijnë dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve telefonike, nëpërmjet platformave të ndryshme VoIP, të cilat kanë filluar të kenë përdorim të lartë jo vetëm në rrjete fikse por edhe në rrjete celulare.


#### **Tregues Financiarë të sektorit<sup>4</sup>**

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2012 ishin rreth 55377 milion lekë të cilat përbëjnë një rritje prej rreth 6.65 % në krahasim me vitin 2011 kur të ardhurat ishin 51922 milion lekë. Rritja e të ardhurave të sektorit ka ardhur kryesisht nga rritja e të ardhurave të operatorëve celularë.


Peshën kryesore të këtyre të ardhurave e zënë ato që vijnë nga rrjetet celulare, të cilat për vitin 2012 ishin 42.01 miliard lekë, kundrejt 39.2 miliard lekë që ishin në vitin 2011, pra një rritje me rreth 7.2 %. Edhe të ardhurat që vijnë nga rrjete fikse (Albtelecom + OA) për vitin 2012 kanë pasur rritje me rreth 4.7%, krahasuar me 2011, nga 12.8 miliard lekë në rreth 13.4 miliardë lekë. Brenda vetë sektorit të rrjeteve fikse vihet re një rritje prej rreth 12 % në të ardhurat e Albtelecom, krahasuar me 2011, por ka një rënie prej rreth 15 % në të ardhurat e OA. Sipërmarrësit alternativë më të mëdhenj sipas të ardhurave janë Abcom, ASC, Primo, Abissnet, Nisatel, IT-Tirana, ATU, të cilët së bashku zënë rreth 5 % të të ardhurave të sektorit, apo mbi 80% të peshës totale të të ardhurave të operatorëve alternativë.

<sup>4</sup> Përditësimi për të ardhurat dhe tregues të tjerë financiarë në këtë raport është për vitin 2012, pasi të dhënat financiare të operatorëve depozitohen në AKEP brenda datë s 10 Prill të vitit pasardhës.

**Figura 3: Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2012)**



**Figura 4: Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2012)**



## TELEFONIA CELULARE

Tabela e mëposhtëme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2012 dhe 2013 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

**Tabela 1: Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2012-2013**

	Njesia	2012	2013	Ndryshimi %
<b>Numri i përdoruesve aktive</b>	<b>numër</b>	3,537,285	3,685,983	4%
<b>Numri i përdoruesve sipas kartave SIM aktive</b>	<b>numër</b>	5,619,607	5,282,350	-6%
<b>Numri i pajtimtarëve që përdorin akses në internet me GPRS/EDGE</b>	<b>numër</b>	1,380,584	713,559	-48%
<b>Numri pajtimtarëve me akses në Internet broadband UMTS në total:</b>				
nëpërmjet aparatit të telefonit celular	<b>numër</b>	594,308	1,119,892	88%
nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	<b>numër</b>	55,405	111,367	101%
<b>Thirrje telefonike (dalëse)të gjeneruara nga përdoruesit</b>	<b>minuta</b>	6,053,089,264	6,769,300,966	12%
<b>Numri i mesazheve SMS të gjeneruara</b>	<b>numër</b>	1,382,610,330	1,689,200,882	22%
<b>Volumi total i të dhënave të transmetuara me GPRS/UMTS</b>	<b>Mbyte</b>	815,104,421	2,590,258,474	218%
<b>Thirrje hyrëse nga rrjete të tjera (Terminim thirrjesh)</b>	<b>minuta</b>	1,046,035,623	990,247,214	-5%
thirrje hyrëse kombëtare	<b>minuta</b>	290,628,294	335,122,643	15%
thirrje hyrëse ndërkombëtare	<b>minuta</b>	755,407,329	655,124,571	-13%
<b>SMS hyrëse nga rrjete të tjera (terminim SMS)</b>	<b>numër</b>	75,084,782	75,386,098	0%

Nga të dhënat e tabelës vihet re se të gjithë treguesit janë më rritje, përveç treguesve të numrit të përdoruesve, pajtimtarët që përdorin GPRS/EDGE dhe terminimit të thirrjeve hyrëse nga rrjete ndërkombëtare. Treguesit me rritje më të madhe janë numri i pajtimtarëve me akses në Internet broadband UMTS (që shpjegon rënien e numrit të përdoruesve me akses GPRS/EDGE), volumi i të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare (që shpjegohet nga rritja e përdorimit të shërbimeve 3G).

### **Numri i përdoruesve celularë**

Numri i përdoruesve celularë matet dhe raportohet në dy mënyra:

- Numri i përdoruesve sipas kartave ‘SIM aktive’ që i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive<sup>5</sup> në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit;
- Numri i ‘përdoruesve aktivë’ që janë përdorues të kartave SIM që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit


AKEP në publikimet e viteve të fundit ka raportuar numrin e përdoruesve celularë sipas dy mënyrave. Praktikën e raportimit të numrit të përdoruesve celularë ndryshojnë në vende të ndryshme, por kohët e fundit ka një rritje të raportimit të numrit të përdoruesve celularë aktivë. Në referenca të tjera në këtë raport, AKEP i referohet kryesisht numrit të përdoruesve celularë sipas “përdoruesve aktivë”, por ndërkohë në disa raste jepen edhe tregues bazuar në numrin e përdoruesve celularë sipas kartave ‘SIM aktive’. Ky përbën ndryshim nga raportet e mëparshme ku si bazë është përdorur numri i përdoruesve celularë sipas ‘kartave SIM

<sup>5</sup> Secili operator ka politikën e veta se kur një kartë SIM (me parapagim) është aktive (që mund të kryejë komunikim) në varësi të kohës së rimbushjes apo përdorimit të fundit të saj.

aktive’, dhe lexuesi duhet të ketë parasysh këtë ndryshim. Të dhënat për numrin e përdoruesve celularë sipas kartave SIM aktive janë të disponueshme që prej vitit 1996, ndërsa sipas treguesit ‘përdorues aktivë’ që prej vitit 2010.

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milionë në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që norma e rritjes ndryshon sipas operatorëve: Plus dhe Vodafone kanë rritje me 9 dhe 11% respektivisht, ndërsa Albtelecom (EM) dhe AMC kanë reduktim 2 dhe 3% respektivisht. Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktivë në periudhën 2010-2013.

**Figura 2: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë aktiv 2010-2013**




Në fund të vitit 2013, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, arriti në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Ndryshimi përbën një rënie vjetore prej 6%, dhe ai varion sipas operatorëve: AMC dhe Vodafone kanë rritje me 10 dhe 11%, Plus ka rritje të vogël me 2%, ndërsa Albtelecom (Eagle Mobile) ka rënie të ndjeshme me 52%. Rënia e madhe e numrit të përdoruesve celularë të EM përbën edhe arsyen e rënies për herë të parë të këtij treguesi, që prej fillimit të shërbimeve celulare në Shqipëri në 1996. Reduktimi i madh i këtij treguesi për EM vjen për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të numrit të kartave SIM aktive nga Eagle Mobile<sup>6</sup>.


Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave SIM në periudhën 2000-2013, Figura 3, paraqet numrin e përdoruesve celularë sipas dy treguesve: ‘përdorues aktivë’ dhe ‘karta SIM aktive’. Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 70% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 63% për EM në 74% për Vodafone. Ndryshimin më të madh të këtij proporcioni e ka EM, nga 31% në fund të 2012 në 63% në fund të 2013 (shiko shënimin për arsyen e këtij ndryshimi të madh), raport që është i ngjashëm me atë të tre operatorëve të tjerë.

<sup>6</sup> EM deri në fund të vitit 2012 ka raportuar për këtë tregues vlerën kumulative të kartave SIM të shitura që prej fillimit të aktivitetit të tij deri në fund të periudhës përkatëse, ndërsa duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, EM ka rivlerësuar numrin e pajtimtarëve duke i'u referuar vetëm kartave SIM aktive në fund të periudhës përkatëse.

**Figura 3. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave dhe SIM 2000-2013**



**Figura 4: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë “aktive” dhe SIM 2010-2013**



Ndërkohë midis operatorëve ka diferenca të mëdha për sa i përket strukturës së përdoruesve: në përdorues me parapagim dhe me kontratë. Tabela e mëposhtëme paraqet peshën që zënë përdoruesit me kontratë në numrin total të përdoruesve, aktivë dhe sipas kartave SIM. Sikurse mund të vihet re përdoruesit me kontratë përbëjnë 13% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë dhe 9 % të numrit të përdoruesve sipas kartave SIM aktive. Midis operatorëve ka diferenca të mëdha. Vodafone me numrin më të madh të përdoruesve celularë, ka vetëm 5-7% përdorues me kontratë dhe 93-95% me parapagim. Dy operatorët më të vegjël kanë një proporcion më të madh të përdoruesve me kontratë, p.sh. Plus për përdoruesit aktivë ka 44%

me kontratë dhe 56% me parapagim. Strukturat e ndryshme parapagim/kontratë midis katër operatorëve tregojnë për një diferencim të strategjive të operatorëve në treg.

**Tabela 5: Struktura e përdoruesve celularë Kontratë/Parapagim (2013)**

	<b>AMC</b>	<b>Vodafone</b>	<b>Eagle Mobile</b>	<b>Plus</b>	<b>Total</b>
	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim
<b>Përdorues Aktiv</b>	13% / 87%	7% / 93%	24% / 76%	44% / 56%	13% / 87%
<b>SIM Aktivë</b>	9% / 91%	5% / 95%	15% / 85%	31% / 69%	9% / 91%

Gjatë vitit 2013 vihet re se ka pasur një rritje të madhe në përdorimin e shërbimeve 3G. Numri i përdoruesve të këtyre shërbimeve është rritur me 90% në krahasim me 2012, duke arritur në 1.2 milion përdorues apo 33% e totalit të përdoruesve aktivë. Ky tregues ka pasur rritje për të tre operatorët celularë me autorizim 3G dhe në të dy llojet e formave të përdorimit të shërbimeve 3G: nëpërmjet aparatit celular (88%) dhe nëpërmjet kartave USB (101%). Rritja e madhe e përdorimit të shërbimeve të aksesit në internet në rrjete celulare në vitin 2013 vihet re dhe nga rritja e madhe prej 218% (apo më shumë se 3 herë) e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare me GPRS/UMTS.

#### **Trafiku telefonik dhe struktura e thirrjeve**


Gjatë vitit 2013 thirrjet dalëse të përdoruesve celularë u rriten me 12% në krahasim me vitin 2012, një normë rritjeje vjetore më e vogël se në vitin 2012 (24%). Rritjen më të madhe e ka pasur Plus me 21% dhe rritjen më të vogël Eagle me -4%. Thirrjet brenda rrjetit edhe për vitin 2013 përbëjnë 93% të totalit të thirrjeve dalëse duke vazhduar tendencën e viteve të fundit dhe përdorimin e madh të paketave tarifore me tarifa shumë të ulëta për thirrjet brenda grupeve të mbyllura brenda rrjetit. Peshat e thirrjeve brenda rrjetit varion nga 78-79% në Plus dhe Eagle Mobile në 94-95% në AMC dhe Vodafone. 9% e totalit të thirrjeve dalëse janë gjeneruar nga përdoruesit më kontratë dhe 91% nga përdoruesit me parapagim, dhe kjo strukturë e thirrjeve është e ngjashme me strukturën e përdoruesve me kontratë dhe me parapagim. Volumi i SMS-ve të gjeneruara nga përdoruesit celularë në 2013 u rrit me 22% në krahasim me 2012, dhe rritja varion nga 7% në Eagle Mobile në 37% në Plus.

Terminimi i thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera në vitin 2013 u reduktua me 5% në krahasim me vitin 2012. Plus dhe Eagle kanë pasur rritje me 60% dhe 15% respektivisht, ndërsa AMC dhe Vodafone kanë pasur reduktim me 3% dhe 12% respektivisht. Ndërkohë dy zërat kryesorë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, terminim nga rrjetet e tjera celulare kombëtare dhe terminim i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, kanë pasur tendencë të kundërta. Terminimi i thirrjeve nga rrjetet e tjera celulare kombëtare është rritur mesatarisht me 18%, dhe rritja varion nga 9% në Eagle në 53% në Plus. Ndërsa terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ka pasur rënie mesatarisht me 13%, e cila vjen për shkak të rënies me 12 dhe 18% për AMC dhe Vodafone respektivisht, ndërsa Eagle dhe Plus kanë pasur rritje me 20% dhe 77% respektivisht. Struktura e thirrjeve hyrëse nga rrjete të tjera ndryshon sipas operatorëve. Thirrjet hyrëse ndërkombëtare përbëjnë mesatarisht 66% të thirrjeve hyrëse, por që varion nga 37% në Plus në 74% në Vodafone. Thirrjet hyrëse nga rrjetet e tjera celulare përbëjnë mesatarisht 32% të thirrjeve hyrëse, e cila varion nga 25% në Vodafone në 60% në Plus.

## Të ardhurat e operatorëve celularë<sup>7</sup>

Për vitin 2012, të ardhurat totale për të katër operatorët celularë ishin rreth 42.01 miliard lekë, krahasuar me 39.2 miliard lekë në vitin 2011, pra një rritje vjetore e të ardhurave me rreth 7.2 %. Në figurën e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave të operatorëve celularë në periudhën 2004-2012, ku mund të vihet re se pas një periudhe 3 vjeçare (2009-2011) me rënie të të ardhurave, në vitin 2012 ka pasur një rritje të të ardhurave, rritje e cila kryesisht ka ardhur nga rritja e Vodafone dhe Plus. Vodafone ka pasur një rritje me rreth 16 %, kurse Plus ka pasur rritje prej rreth 144%, krahasuar me të ardhurat e vitit 2011. Dy operatorët e tjerë, AMC dhe EM kanë një rënie në të ardhurat e tyre me 7 % dhe 11% respektivisht.

**Figura 6: Ecuria e të ardhurave të operatorëve celularë 2004-2012**



*Burimi: Raportimet e operatorëve sipas Formularit E të treguesve të publikuar nga AKEP.*

Të ardhurat e operatorëve celularë gjenerohen nga dy grupe të përgjithshme: të ardhura nga shërbimet me pakicë dhe të ardhura nga shërbimet me shumicë të interkoneksionit. Të ardhurat nga shërbimet e interkoneksionit për vitin 2012 janë rritur me 42% (varion nga 0% në 152%) dhe këto të ardhura përbënin 34-38% të të ardhurave totale sipas operatorëve, ndërsa për 2011 ky proporcion varionte në 29-37%. Peshën kryesore në të ardhurat nga interkoneksioni e zënë të ardhurat nga terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, për shkak të trafikut dhe tarifës më të lartë të terminimit të këtyre thirrjeve. Të ardhura nga shërbimet me pakicë janë reduktuar mesatarisht me 10%, ku të ardhurat e Vodafone, EM dhe AMC janë reduktuar me 9-18%, ndërsa të ardhurat me pakicë të Plus janë rritur me 140%. Pra të ardhurat totale në 2012 janë rritur për shkak të rritjes së të ardhurave nga shërbimet me shumicë, kryesisht nga rritja e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

## Pjesët e tregut

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e pjesëve të tregut për 2010-2013 për numër pajtimtarësh, thirrje dalëse dhe SMS dhe për të ardhurat(2009-2012). Nga të dhënat vihet re se:

<sup>7</sup> Përditësimi për të ardhurat në këtë raport është për vitin 2012, pasi të dhënat financiare të operatorëve depozitohen në AKEP brenda datës 10 prill të vitit pasardhës.



- Për treguesit e numrit të përdoruesve, Vodafone në 2013 ka pjesë tregu në nivele 42-45% për përdorues aktivë dhe SIM, të cilat janë rritur me 3 dhe 6 pikë përqindje në krahasim me 2012. AMC në 2013 ka rritur pjesën e tregut për përdorues të kartave SIM me 6 pikë përqindje, duke arritur në 39%, ndërsa për përdorues aktiv ka 37% pjesë tregu. Në segmentin e përdoruesve me kontratë pjesën më të madhe të tregut e ka AMC me 37% (rritje me 6 pikë përqindje nga 2012) ndërsa Vodafone ka një pjesë tregu shumë më të vogël (22%) në krahasim me numrin total të përdoruesve. Pjesët e tregut të Plus nuk kanë pasur ndryshim në 2013, duke ruajtur nivelin 6% në përdorues aktiv dhe karta SIM. Eagle ka pjesë tregu me 12 % në përdorues aktiv, çka është relativisht e qëndrueshme që prej 2011, ndërkohë që ka rënie të madhe në pjesët e tregut të përdoruesve sipas kartave SIM (nga 25% në 13%) dhe përdorues me kontratë (nga 36% në 21%). Rënia e madhe e pjesëve të tregut të Eagle ka ardhur për shkak të ndryshimit të mënyrës së matjes së përdoruesve të kartave SIM.
- Pjesët e tregut të thirrjeve dalëse dhe SMS-ve në 2012-2013 nuk kanë ndryshime të ndjeshme, dhe Vodafone ka pjesën më të madhe të tregut në 2013 me 51% në thirrje dalëse dhe 73% në SMS.
- Pjesët e tregut në të ardhura për 2012 rezultojnë me rritje për Vodafone, e cila zotëron 56% pjesë tregu, ndërsa AMC ka rënie me 5 pikë përqindje duke arritur në 29% pjesë tregu. Eagle dhe Plus zotërojnë 14-15% së bashku në 2012-2013, dhe në 2013 Eagle ka pasur rënie të pjesës së tregut ndërsa Plus ka pasur rritje.

**Tabela 1: Pjesët e tregut celularë për disa tregues kryesorë 2010-2013<sup>8</sup>**

		AMC	VODAFONE ALBANIA	EAGLE MOBILE	PLUS COMMUNICATION
Përdorues Aktivë	2013	37%	45%	12%	6%
	2012	40%	42%	12%	6%
	2011	37%	44%	13%	6%
	2010	44%	36%	19%	1%
Përdorues (Karta SIM)	2013	39%	42%	13%	6%
	2012	33%	36%	25%	6%
	2011	37%	35%	21%	8%
	2010	44%	37%	18%	1%
Përdorues me Kontratë	2013	37%	22%	21%	20%
	2012	31%	18%	36%	15%
	2011	35%	24%	34%	7%
	2010	43%	30%	27%	-
Thirrje dalëse	2013	39%	51%	7%	3%
	2012	39%	50%	8%	3%
	2011	37%	51%	10%	2%
	2010	46%	45%	9%	-
SMS	2013	21%	73%	5%	1%
	2012	20%	73%	6%	1%

<sup>8</sup> Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

	2011 <sup>9</sup>	27%	64%	8%	1%
	2010	34%	57%	9%	-
<b>Të ardhura</b>	<b>2012</b>	<b>29%</b>	<b>56%</b>	<b>10%</b>	<b>5%</b>
	<b>2011</b>	<b>34%</b>	<b>52%</b>	<b>12%</b>	<b>2%</b>
	2010	40%	48%	12%	-

### Pjesë tregu: terminim (trafik dhe të ardhura)

#### Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor për përdorues celularë në 2011 deri në 2013, sipas dy treguesve të përdoruesve: përdorues aktiv dhe karta SIM aktive. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Këta tregues janë llogaritur për të gjithë trafikun e gjeneruar dhe marrë gjatë periudhës pjestuar me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës (mesatarja e numrit të përdoruesve në fillim dhe në fund të periudhës). Thirrjet dalëse përfshijnë gjithë trafikun e origjinar nga përdoruesit celularë ndërsa thirrjet hyrëse përfshijnë thirrjet e marra nga përdoruesit, nga rrjete të tjera dhe nga i njëjti rrjet. Përdorimi mujor i SMS i referohet vetëm mesazheve të dërguara. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme për përdorimin mesatar të një përdoruesi celular, i përlllogaritur me të dhënat e katër operatorëve celularë. Gjithashtu treguesit janë përlllogaritur për numrin e përdoruesve celularë aktiv dhe sipas kartave SIM.

**Tabela 2: Përdorimi mesatar i shërbimeve celulare 2011-2013<sup>10</sup>**

	2011	2012	2013	Ndryshimi 2013 me 2012
<b>Përdorues Aktiv</b>				
Thirrje dalëse në muaj	130	152	156	3%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	147	168	167	-1%
MOU*	277	319	324	2%
SMS (dalëse) në muaj	19	35	39	11%
<b>Përdorues Karta SIM</b>				
Thirrje dalëse në muaj	83	93	103	11%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	94	103	111	8%
MOU*	177	195	214	10%
SMS (dalëse) në muaj	12	21	26	24%

Siç mund të vihet re nga tabela edhe për vitin 2013 është vënë re një rritje e përdorimit mesatar mujor për përdorues të shërbimeve celulare. Gjatë vitit 2013, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 156 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 167 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 324 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe ka dërguar 39 SMS në muaj. Këto vlera përdorni janë më të

<sup>9</sup> Pjesët e tregut për SMS për vitin 2011 të publikuara më parë janë korigjuar. Lexuesi lutet t'i referohet këtyre vlerave të rishikuara për SMS për vitin 2011.

<sup>10</sup> Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit të kartave SIM aktive: 103 minuta dalëse, 111 minuta hyrëse dhe 214 minuta komunikim thirrje dhe 26 SMS në muaj.

AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më afër treguesve të matur me përdorues aktivë, pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh të kartave SIM janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karka SIM të operatorëve celularë shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohëshëm apo vizitave në Shqipëri).

### **Tarifat celulare**


Tarifat e shërbimeve celulare kanë vazhduar tendencën e reduktimit të tyre edhe në vitin 2013. Kjo mund të vihet re nga ecuria e shpenzimeve për shportat OECD dhe krahasimi me rajonin dhe mesataren e BE, sipas publikimit të Cullen International në Shkurt 2014. Reduktime të ndjeshme rezultojnë të jenë kryer në shpenzimet për shportat e konsumit mesatar dhe të lartë:

- Shporta e konsumit të Ulët (low usage): rritje mesatarisht me 6%, por përsëri 16% më e ulët se mesatarja e BE/rajonit
- Shporta e konsumit të Mesëm (medium usage): reduktim mesatarisht me 35%.
- Shporta e konsumit të Lartë (high usage): reduktim mesatarisht me 28%.

Niveli mesatar i shpenzimeve për shportat OECD rezulton të jetë në nivele afërsisht sa niveli mesatar në vendet e BE dhe rajonit për konsum mesatar dhe të lartë dhe më të ulëta se këto nivele për konsum të ulët.

Tregues të tjerë të shpenzimeve të përdoruesve celularë përfshijnë treguesit e ARPU<sup>11</sup> dhe ARPM<sup>12</sup>, që masin të ardhurën mesatare të operatorëve (shpenzimin mesatar të përdoruesve) për përdorues dhe minutë. Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPM sic mund të vihet re nga grafiku më poshtë për vitin 2012 ishte ndër më të ulët në rajon dhe 2-3 herë më i ulët se mesatarja në vendet e BE.

**Figura 7: E Ardhura Mesatare Për Minutë ARPM (2012)**



Burimi: Cullen International Report, Shkurt 2014

<sup>11</sup> ARPU (Average Revenue Per Users-E Ardhura Mesatare Për Përdorues)

<sup>12</sup> ARPM (Average Revenue Per Minute-E Ardhura Mesatare Për Minutë)

## TELEFONIA FIKSE

Telefonia fikse edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar tendencën rënëse të viteve të fundit, e cila megjithëse është në linjë me tendencën rënëse në vendet e BE, norma e penetrimit prej 10% është shumë më ulët se në vendet e BE. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie një renie me 10%. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me 9% si dhe rënies me 13% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë. Rënia e madhe në numrin e pajtimtarëve të operatorëve alternativë rezulton të ketë ardhur kryesisht nga ndryshimi në të dhënat e operatorit më të madh alternativ Abcom, i cili ka raportuar një reduktim me rreth 20 mijë pajtimtarë. Ky reduktim nga Abcom vjen për shkak të mënyrës së matjes prej tij të numrit të pajtimtarëve telefonikë, duke raportuar vetëm ata pajtimtarë që përdorin dhe paguajnë për shërbim telefonik<sup>13</sup>. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Albtelecom dhe operatorëve alternativë në periudhën 2000-2013.

**Figura 1: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2013**





Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve kryesorë në periudhën 2010-2013. Nga të dhënat vihet re se dy operatorët më të mëdhenj Albtelecom dhe Abcom kanë pasur reduktime në 2013, dhe reduktimi më i madh i Abcom me 97% për arsytet e shpjeguara në shënimet e mësipërme. ASC ka pasur pothuajse dyfishim të numrit të pajtimtarëve në 2013, dhe Nisatel ka pasur rritje me 30%. AMC me shërbimin AMC fiks ka pasur rritje me 14%, por përsëri është me reduktim nga koha e fillimit të ofrimit të këtij shërbimi.

<sup>13</sup> Abcom është një operator kabllor dhe shërbimi telefonik ofrohet bashkë me shërbimin e internetit. Për vitet e mëparshme numri i pajtimtarëve telefonikë raportohej i barabartë me ata të internetit. Duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, Abcom konsideron si pajtimtarë telefonikë vetëm ata pajtimtarë që e përdorin apo paguajnë për shërbim telefonik.

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	AMC Fiks	OA te tjere	Total Fiks
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	-	20,456	331,502
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	7,565	30,090	338,844
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	6,119	28,996	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	7,166	6,950	27,975	281,200
Ndryshimi 2013/2012	-9%	-59%	97%	30%	14%	-4%	-10%

Figura e mëposhtme paraqet pjesët e tregut të operatorëve kryesorë të telefonisë fikse, ku vihet re Albtelecom vazhdon të ketë 75% pjesë tregu, pasi rënia e numrit të pajtimtarëve ka qenë tendencë e të gjithë tregut. Dy operatorët më të mëdhenj alternativë, ASC dhe Abcom, kanë secili 5% pjesë tregu.

**Figura 2: Pjesët e tregut të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2013**



### **Tarifat e telefonisë fikse**

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar tendenca viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse për promovim të paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Vihet re se këto lloj paketash kanë filluar të ofrohen edhe për segmentin e pajtimtarëve biznes krahas segmentit familjarë, nga Albtelecom dhe operatorët kryesorë alternativë. Dy operatorët më të mëdhenj alternativë, Abcom dhe ASC, janë ofruer të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara më të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët.

Rritja e përdorimit të pajtimtarëve të Alebtelecom dhe lojtarëve të tjerë kryesorë në treg të paketave tarifore alternative, me përfshirje minutash thirrje telefonike dhe akses në internet në pagesa mujore fikse, si dhe presioni konkurrues i tarifave të telefonisë celulare në

telefoninë fikse, ishin ndër faktorët kryesorë që çuan në de-rregullimin e tarifave me pakicë të telefonisë fikse të paketave tarifore standarte të Albtelecom. Ky de-rregullim gjykohet të nxisë fleksibilitetin dhe inovacionin e Albtelecom në ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe shërbimeve të reja në kushtet e migrimit drejt rrjetit NGN/NGA të Albtelecom.


## INTERNETI

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Tabela e mëposhtme paraqet numrin e pajtimtarëve broadband fiks dhe 3G, dhe numrin e pajtimtarëve si përqindje e popullsisë dhe numrit të familjeve (penetrimi). Në 2013 të dy segmentet e aksesit broadband fiks dhe 3G (me karta USB/modem ) kanë pasur rritje me 14% dhe 101% respektivisht. Norma e penetrimit për të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje.

**Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband dhe normat e penetrimit 2011-2013**

	Numri i pajtimtarëve			Penetrimi				
	Total Fiks	Total 3G	Total Fiks + 3G	Popullsi			Familje	
				Fiks	3G	Fiks +3G	Fiks	Fiks +3G
<b>2011</b>	139,697	34,493	174,190	4.9%	1.2%	6.2%	17%	22%
<b>2012</b>	160,088	55,405	215,493	5.7%	2.0%	7.6%	20%	27%
<b>2013</b>	182,556	111,367	293,923	6.4%	3.9%	10.4%	22%	37%
<b>Ndryshimi 2013/2012</b>	14%	101%	<b>36%</b>					

**Figura 2: Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband 2007-2013**



Numri i pajtimtarëve me akses broadband me rrjete fikse pati një rritje prej 14%, ku shumica e operatorëve kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve. Altelecom në 2013, pati rritje me 10% të numrit të pajtimtarëve broadband. Ndër operatorët alternativë fikse Abcom vazhdon të jetë operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 43 mijë në fund të vitit 2013, që përbën një rritje prej 21% nga viti 2012. Rritje të madhe kanë pasur edhe Abissnet dhe ASC si dy operatorët e tjerë alternativë më të mëdhenj me 16% dhe 31% respektivisht.

**Tabela 3: Numri i pajtimtarëve me akses broadband fikse 2010-2013**

	Altelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Broadband Fiks
<b>2010</b>	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
<b>2011</b>	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
<b>2012</b>	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
<b>2013</b>	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
<b>Ndryshimi 2013/2012</b>	10%	21%	16%	31%	7%	14%

Numri i pajtimtarëve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem për përdorim me kompjuter) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 111 mijë nga 55 mijë në fund të 2012, që përbën dyfishim të numrit apo rritje me 101%. Të dy operatorët celularë Vodafone dhe AMC, kanë pasur rritje të ndjeshme me 76 dhe 80% respektivisht, si dhe Eagle Mobile si operatori më i ri që filloi ofrimin e shërbimeve 3G në 2013, ka arritur të ketë rreth 13 mijë pajtimtarë gjatë vitit 2013. Rritje të madhe me 88% pati edhe numri i përdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare, duke arritur në rreth 1.1 milion në fund të 2013, krahasuar me 594 mijë në 2012. Në total numri i përdoruesve me akses broadband 3G (aparate celulare dhe karta USB) në 2013 arriti në 1.2 milion në krahasim me 694 mijë në 2012.


**Tabela 3: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G 2010-2013**

	AMC		Vodafone		EM		Total	
	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular
<b>2011</b>	<b>9,000</b>	46,000	<b>25,493</b>	202,756	<b>N/A</b>	N/A	<b>34,493</b>	248,756
<b>2012</b>	<b>17,833</b>	222,882	<b>37,572</b>	371,426	<b>N/A</b>	N/A	<b>55,405</b>	594,308
<b>2013</b>	<b>32,138</b>	279,428	<b>66,086</b>	568,207	<b>13,143</b>	272,257	<b>111,367</b>	1,119,892
<b>Ndryshimi 2013/2012</b>	<b>80%</b>	25%	<b>76%</b>	53%	<b>N/A</b>	N/A	<b>101%</b>	88%

### Tarifat e aksesit broadband

Shërbimi i aksesit broadband në 2013 pati zhvillime pozitive në terma të rritjes së numrit të pajtimtarëve, të referuar më sipër, si dhe në terma të reduktimit të tarifave dhe rritjes së shpejtësisë së aksesit broadband. Figura e mëposhtme paraqet krahasimin e tarifave të aksesit broadband në Internet nga rrjete fikse, për shpejtësi të ndryshme (pa limit download), me vendet e rajonit, ku vihet re se tarifat në Shqipëri janë në nivelin mesatar të vendeve të rajonit, për operatorin incumbent (Albtelecom) dhe operatorët alternativë.

**Figura 4: Krahasimi i tarifave të aksesit broadband me vendet e rajonit 2013**



Burimi: Cullen International Shkurt 2014



Niveli i tarifave të aksesit broadband të Albtelecom për paketat më të përdorura 2-4Mbps është reduktuar me 17-33%, ndërsa për Abcom (operatori më i madh alternativ) reduktimi është në 20-28%. Reduktime të ndjeshme kanë pësuar edhe tarifat e aksesit internet 3G, me karta USB dhe aparate celulare, të cilat kanë çuar në rritje të ndjeshme të numrit të këtyre pajtimtarëve dhe trafikut data në rrjetet celulare.

Shpejtësia më e përdorur e aksesit në internet nga rrjete fikse është rritur nga 2-4 Mbps në 2012 në 4-8 Mbps në 2013. Në 2013 52% e pajtimtarëve ADSL të Albtelecom kishin akses në internet me shpejtësi mbi 4 Mbps.

## **2. Rregullimi Ekonomik i Tregut**

### **2.1. Analizat e Tregjeve**

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2013 kreu proceset e mëposhtëme për analizat e tregut:

- Miratimi i versionit final të Analizës së tregjeve të telefonisë fikse
- Këshillim Publik i Analizës së tregjeve të linjave me qira
- Këshillim publik i Analizës së tregjeve të aksesit broadband me shumicë dhe LLU
- Këshillim publik i Analizës së tregut të terminimit të SMS-ve
- Miratimi i shtesave dhe ndryshimeve të rregullores së Analizës së Tregut

#### **2.2.1 Procesi i analizave të tregjeve gjatë vitit 2013:**

##### **❖ Analiza e tregut të telefonisë fikse**

AKEP në vijim të këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut të telefonisë fikse në vitin 2012, me Vendim nr.2336, datë 30.07.2013 miratoi versionin final të dokumentit të analizës së tregut, dhe me Vendimet nr.2337, datë 30.07.2013, Nr.2338 dhe 2339, datë 31.07.2013 përcaktoi sipërmarrësit me FNT dhe masat rregulluese përkatëse për tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjeve me shumicë të interkoneksionit në rrjetet fikse (origjinim, terminim dhe tranzitim). Tregjet përkatëse të analizuarra janë:

- 1) Tregu me pakicë i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse (*për pajtimtarë familjarë dhe jo –familjarë*);
- 2) Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vendndodhje fikse (*për pajtimtarë familjarë dhe jo –familjarë*);
- 3) Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjete telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse;
- 4) Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;
- 5) Tregu me shumicë i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse.

Tregjet përkatës me shumicë janë të njëjta me ato të analizuarra më parë nga AKEP në 2010, ndërsa tregjet me pakicë janë ri-segmentuar në dy tregje, por përsëri përmbajnë të njëjtat shërbime si të gjashtë tregjet e përkufizuar në 2010.

Tabela e mëposhtëme parqet një përmbledhje të sipërmarrësve të përcaktuar me FNT, masat rregulluese përkatëse dhe referencën e Vendimit të AKEP.

Nr.	Tregu Përkatës	Ofruesit	Sipërmarrësit me FNT	Masat rregulluese	Referenca e Vendimit
1	Tregu me pakicë i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse (për pajtimtarë familjarë dhe jo-familjarë);	Albtelecom, AMC (AMC fiks) dhe 77 operatorë alternativë	Albtelecom	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Transparencë</li> <li>- Mos-diskriminim</li> <li>- Ofrim i Z(P)B për pajtimtarët</li> </ul>	<a href="#">Vendim</a> nr.2337, datë 30.07.2013
2	Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vendodhje fikse (për pajtimtarë familjarë dhe jo-familjarë);				
3	Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjete telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse;	Albtelecom, AMC (AMC fiks) dhe 77 operatorë alternativë	Albtelecom	<ul style="list-style-type: none"> <li>- CS/CPS</li> <li>- Mos-diskriminim</li> <li>- Transparencë (RIO)</li> <li>- Orientim në kosto</li> <li>- Akses dhe interkoneksion</li> <li>- Kontroll çmimi</li> <li>- AS/CA</li> </ul>	<a href="#">Vendim</a> nr.2337, datë 30.07.2013
4	Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;	Albtelecom, AMC (AMC fiks) dhe 77 operatorë alternativë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Albtelecom</li> <li>- AMC (AMC Fiks)</li> <li>- 77 operatorë alternativë</li> </ul>	<p><b>Albtelecom</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mos-diskriminim</li> <li>- Transparencë(RIO)</li> <li>- Orientim në kosto</li> <li>- Akses dhe interkoneksion</li> <li>- Kontroll çmimi</li> <li>- AS/CA</li> </ul> <p><b>AMC dhe 77 OA</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mos-diskriminim</li> <li>- Transparencë (jo RIO)</li> <li>- Akses dhe interkoneksion</li> <li>- Kontroll çmimi</li> </ul>	<p><a href="#">Vendim</a> nr.2337, datë 30.07.2013</p> <p><a href="#">Vendim</a> nr.2339. datë 31.07. 2013.</p> <p><a href="#">Vendim</a> nr.2338, datë 31.07. 2013.</p>
5	Tregu me shumicë i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse.	Albtelecom, AMC (AMC fiks) dhe 77 operatorë alternativë	Albtelecom		<a href="#">Vendim</a> nr.2337, datë 30.07.2013

Shumica e përcaktimeve me FNT dhe masat rregulluese janë të njëjta me analizat e mëparshme, përveç ndryshimeve të mëposhtme:

- De-rregullimi i tarifave me pakicë të Albtelecom duke filluar nga 1.01.2014.

AKEP vendosi të heqë detyrimin e kontrollit të tarifave me pakicë të Albtelecom duke filluar nga 1.01.2014, bazuar në reduktimin e rëndësisë së paketave standarte tarifore për shkak të rritjes të paketave tarifore opsionale (shportë thirrje dhe thirrje dhe akses në Internet), presionit konkurrues nga shërbimet celulare, përvojës në vende të tjera, etj.

- Shpallja me FNT e të gjithë operatorëve të rrjeteve publike të telefonisë fikse për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale fikse

AKEP vendosi që përveç Albtelecom të shpallë me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjete fikse edhe operatorët alternativë si dhe AMC (AMC fiks), për shkak të problemeve të hasura në vitet e fundit me tarifën e terminimit në rrjetet e këtyre operatorëve. Gjithsesi, masat rregulluese për këta operatorë janë më të pakta se për Albtelecom dhe nuk përbëjnë barrë të rëndë për sipërmarrësit.

- Reduktimi i segmenteve të terminimit/origjinimit/tranzitimit në rrjetin Albtelecom.

Në lidhje me rregullimin e tarifave të Interkoneksionit, AKEP vendosi aplikimin e reduktimit të përshkallëzuar të tarifave të terminimit në rrjetin Albtelecom dhe të operatorëve të tjerë duke filluar nga 1.01.2014, duke reduktuar segmentet e terminimit/origjinimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom nga 3 në 2 dhe tranzitimin nga 2 në 1. Këto ndryshime u kryen për shkak të evolimit të teknologjisë, zhvillimeve në tregjet me pakicë dhe ndryshimeve në planin e numeracionit. Detajet e reduktimit të tarifave janë dhënë në Seksionin e Rregullimit të Tarifave.

#### ❖ **Analiza e tregut të linjave me qira**

Më 31.07.2013, AKEP publikoi për këshillim publik [analizën e tregut](#) për tregjet me pakicë dhe shumicë të linjave me qira, që përmban analizën e tregjeve të mëposhtëme:

- 1) Tregu me pakicë i minimumit të linjave me qira (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qira deri në dhe përfshirë 2Mbit/sek)
- 2) Tregu me shumicë i segmenteve terminuese të linjave me qira.
- 3) Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qira.

Në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, AKEP ka propozuar midis të tjerave de-rregullimin e tregut me pakicë të minimumit të linjave me qira dhe tregut me shumicë të linjave kryesore (trunk) të linjave me qira, dhe përcaktimin e Albtelecom sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira, me masa rregullatore të ngjashme me masat e vendosura në 2011.

Procesi i këshillimit publik u mbyll më 1.10.2013 dhe AKEP është në proces vendim-marrje të miratimit të versionit final të këtij dokumenti analize dhe vendimeve përkatëse për FNT dhe masat rregulluese përkatëse.

#### ❖ **Analiza e tregut me shumicë të aksesit broadband**

Më 31.07.2013, AKEP publikoi për këshillim publik [analizën e tregut](#) për tregjet me shumicë të aksesit broadband, që përmban analizën e tregjeve të mëposhtëme:

- 1) Tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plotë dhe të ndarë - full LLU dhe shared LLU) nga vendodhje fikse.
- 2) Tregu me shumicë i aksesit broadband (bitstream).

Në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, AKEP ka propozuar midis të tjerave përcaktimin e Albtelecom sipërmarrës me FNT në dy tregjet me shumicë të analizuara dhe masa rregullatore të ngjashme me masat e vendosura në 2011.

Procesi i këshillimit publik u mbyll më 1.10.2013 dhe AKEP është në proces vendim-marrje të miratimit të versionit final të këtij dokumenti analize dhe vendimeve përkatëse për FNT dhe masat rregulluese përkatëse.

#### ❖ **Analiza e tregut me shumicë të terminimit të SMS-ve**

Më 30.10.2013, AKEP publikoi për këshillim publik [analizën e tregut](#) me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet individuale celulare. Në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, AKEP ka propozuar midis të tjerave përcaktimin e katër operatorëve celularë si sipërmarrës me FNT dhe masa rregullatore të ngjashme me masat e vendosura në 2011, duke propozuar njëkohësisht reduktime të mëtejshme të tarifave të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare.

Procesi i këshillimit publik u mbyll më 31.12.2013 dhe AKEP është në proces vendim-marrje të miratimit të versionit final të këtij dokumenti analize dhe vendimeve përkatëse për FNT dhe masat rregulluese përkatëse.

## **2.2 Amendime të Rregullores së Analizës së Tregut**

AKEP duke marrë në konsideratë evolucionin e tregjeve në Shqipëri, përfundimet e analizave të tregjeve si dhe rekomandimet më të fundit të Komisionit Europian dhe BEREC, më 7.03.2013-7.04.2013, nxorri për këshillim publik propozimet për amendimin e Rregullores nr.9, Për Analizën e Tregut, miratuar më 17.07.2009. Më [31.07.2013](#), AKEP miratoi amendimet e Rregullores së Analizës së Tregut. Amendimi kryesor ishte ndryshimi i listës së tregjeve përkatës, e cila tashmë ka 7 tregje të Rekomandimit të vitit 2007 të KE, në vend të 16 tregjeve të rekomandimit të vitit 2003 të KE. AKEP mund të analizojë edhe tregje të cilat nuk janë pjesë e listës së rregullores, ose listës së rekomandimit të KE në fuqi, pas aplikimit të testit të 3 kriterëve. Amendimet përfshijnë edhe referenca me rekomandimet më të fundit të KE dhe BEREC.

## **2.3 Amendime të Rregullores së Statistikave**

AKEP duke marrë në konsideratë zhvillimet pozitive për përdorimin e modulit on-line të AKEP ([www.aplikimeonline.al](http://www.aplikimeonline.al)) si lehtësi për raportimin e të dhënave nga operatorët si dhe dinamikën e sektorit dhe shërbimet e reja që futen në treg dhe ndryshimet në treguesit që AKEP duhet të raportojë në organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare, më 26.12.2013 vendosi nxjerrjen në këshillim publik të amendimeve të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010

“Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”. Ndryshimet kryesore të propozuara synojnë:

1. lehtësimin e procedurave të operatorëve për depozitimin e të dhënave në AKEP duke përdorur modulën on-line në faqen zyrtare të AKEP;
2. rritjen e fleksibilitetit të përmbajtjes së formularëve përkatës, për të dhënat periodike të raportuara nga operatorët
3. rritjen e cilësisë së të dhënave të raportuara në AKEP nga sipërmarrësit.

Periudha e këshillimit publik përfundon më 5.02.2014.

## 2.4. Masat rregullatore

### ❖ Ofertat Rerencë të Interkoneksionit (RIO)

Në vijim të Vendimit nr.2337, datë 30.07.2013, për përcaktimin e Albtelcom sipërmarrës me FNT në tregjet e telefonisë fikse, AKEP me Vendimin nr.2403, datë 26.12.2013, miratoi ofertën referencë të interkoneksionit (RIO) të depozituar nga Albtelcom duke imponuar disa ndryshime. Në zbatim të përfundimeve të Analizës së tregut të telefonisë fikse dhe vendimit për FNT të Albtelcom më 30.07.2013, RIO e përditësuar e Albtelcom përmban:

- tarifat e reja të interkoneksionit të miratuara nga AKEP;
- reduktimin e pikave të interkoneksionit të Albtelcom dhe segmenteve të terminimit/originimit/tranzitimit.

Reduktimi i pikave të interkoneksionit të Albtelcom është parashikuar të mos ketë efekte negative tek operatorët alternativë të telefonisë fikse.

### ❖ Rregullimi i tarifave

#### ➤ Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare

Në vijim të vendimeve të AKEP në vitin 2011 dhe 2012, për rregullimin e tarifave të terminimit të mesazheve SMS dhe thirrjeve në rrjetet celulare, gjatë vitit 2013 katër operatorët celularë zbatuan reduktimet e dhëna në tabelat e mëposhtëme.

	1.09.2012- 31.08.2013	1.09.2013- 31.08.2014	1.09.2014- 31.08.2015	1.09.2015-
<b>AMC, Vodafone</b>	<b>6.1</b>	<b>4.57</b>	<b>4.57</b>	<b>4.57</b>
<b>Eagle Mobile</b>	<b>6.52</b>	<b>4.57</b>	<b>4.57</b>	<b>4.57</b>
<b>Plus Communications</b>	<b>12.92</b>	<b>8.85</b>	<b>6.52</b>	<b>4.57</b>

*Shënim: Tarifat në lekë/minutë, TVSH nuk është e përfshirë*

Tarifa e terminimit prej 4.57 lekë/min është tarifa bazuar në kostot BULRAIC (kostot e një operatori eficient në periudhë afatgjatë), të përcaktuar me konsulencë ndërkombëtare në vitin 2010. AKEP në Dhjetor 2013, ngriti një Grup Pune për orientimin e tarifave të terminimit të

thirrjeve në rrjetet celulare në kostot BULRIC i pastër (pure LRIC), sipas rekomandimit të Komisionit Evropian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC)<sup>14</sup>. AKEP me vendimin Nr. 2412, datë 16.01. 2014 për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”, ka miratuar nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit të përgatitur nga Grupi i Punës. AKEP me vendimet nr.2341-2345, datë 13.03.2014 miratoi dokumentacionin final për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, duke vendosur për reduktime të mëtejshme të tarifave të terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë, sipas vlerave të tabelës së mëposhtëme.

**Tabela 1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit celular në Shqipëri 2014-në vijim**

	1.09.2013	1.04.2014	1.04.2015	1.01.2016-
Vodafone/AMC	4.57	2.66	2.04	1.48
Albtelecom (EM)	4.57	4.00	2.66	1.48
Plus	8.85	6.52	4.00	1.48

*Shënim: Tarifat në lekë/minutë pa TVSH*

**Tabela 2: Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në Shqipëri**

	1.04.2014/aktuale	1.04.2015/aktuale	1.01.2016/aktuale
Vodafone/AMC	-42%	-55%	-68%
Albtelecom (EM)	-12%	-42%	-68%
Plus	-26%	-55%	-83%

#### ❖ Terminimi i SMS-ve në rrjetet celulare

Në vijim të Vendimeve nr.1710-1713, datë 31.10.2011 për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre dhe masat rregulluese për FNT, gjatë vitit 2013, më 1.09.2013, u implementuan faza e tretë e reduktimit të tarifave të terminimit të SMS-ve, duke reduktuar këto tarifa nga 3 lekë/SMS në 2011 në 1.48 lekë/SMS. Në dokumentin e [analizës së tregut](#) të terminimit të SMS-ve, të publikuar për këshillim publik më 30.10.2013-31.12.2013, AKEP propozoi midis të tjerave reduktime të mëtejshme të tarifave të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare.

#### ❖ Tarifat e interkoneksionit në rrjetet fikse

Në vijim të përfundimeve të analizës së tregut të telefonisë fikse, AKEP me vendimet nr.2337-2339, datë 30.07.2013 dhe 31.07.2013, vendosi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit/origjinimit/tranzitimit në rrjetin Albtelecom dhe tarifave të terminimit në rrjetet e 77 OA dhe AMC (AMC fiks) sipas tabelave të mëposhtëme.

<sup>14</sup> COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC)

**Tabela 4: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2013-2015**

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II	Ndryshimi	
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri në një Vendim tjetër tëAKEP	Faza I/Aktuale	Faza II/Aktuale
<b>Terminim – Origjinim (lekë/minutë)</b>					
<b>Lokal</b>	1.50	1.34	1.19	-11%	-21%
<b>Njëfish</b>	2.50	1.34	1.19	-46%	-52%
<b>Dyfish</b>	3.50	2.68	1.85	-24%	-47%
<b>Tranzitim (lekë/minutë)</b>					
<b>Njëfish</b>	1.50	1.71	1.32	14%	-12%
<b>Dyfish</b>	2.50	1.71	1.32	-32%	-47%
<b>Tarifë fikse për thirrje <sup>15</sup>(lekë /thirrje)</b>					
<b>Tarifë për thirrje</b>	0.83	0.53	0.38	-36%	-54%

<sup>15</sup> Aplikohet për terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

**Tabela 5: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë fikse 2013-2015**

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri në një Vendim tjetër të AKEP
<b>Tarifa lekë/minutë</b>			
<b>Lokal</b>	1.5-1.95	1.50	1.34
<b>Mesatare-Njëfish/dyfish</b>	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77
<b>Tarifë fikse për thirrje (lekë/thirrje)</b>	0.83	0.53	0.38

*Shënim: Tarifat janë pa TVSH.*

**Tabela 6: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetin AMC për thirrjet drejt AMC Fiks 2013-2015 (FINAL)**

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri në një Vendim tjetër të AKEP
<b>Terminimi lekë/minutë</b>	1.50 ose 2.5	1.34	1.19
<b>Tarifë fikse për thirrje</b>		0.53	0.38

*Shënim: Tarifat janë pa TVSH.*



## ❖ **Orientimi në kosto dhe detyrimet për AS/CA (Account Separation/Cost Accounting)**

### ➤ **Depozitimi nga Albtelecom i Kostove të Shërbimeve**

Albtelecom në zbatim të kërkesës së AKEP (komunikimet e AKEP me Albtelecom në periudhën Mars-Qershor 2012) për përlllogaritjen e kostove të shërbimeve të ofruara prej tij duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet e ndodhura në rrjetin Albtelecom, më datë 5.11.2012 ka depozituar në AKEP dokumentin “Top down cost model of Albtelecom network”. AKEP, ngriti një Grup Pune me ekspertë të AKEP për “Shqyrtimin e dokumentit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. mbi kostot e shërbimeve”. Grupi Punës ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Albtelecom, ka kërkuar informacione dhe dokumente shtesë si dhe ka zhvilluar një takim me Albtelecom dhe konsulentin e Albtelecom me 11.02.2013. Për verifikimin e kostove të paraqitura nga Albtelecom, Grupi Punës i është referuar rekomandimeve të KE, ERG/IRG dhe BEREC dhe praktikave më të mira për AS/CA, apo me specifikisht për kostot TD LRIC të cilat janë përgatitur nga Albtelecom. Grupi i Punës, gjykoj se sqarimet e dhëna në dokumentacion si dhe në takim dhe në informacionin shtesë të dërguar nga konsulenti i Albtelecom, nuk janë bindëse për të vërtetuar se modeli dhe rezultatet e modelit të paraqitur nga Albtelecom, paraqesin kostot efçente të ofrimit të shërbimeve të Albtelecom. Ky gjykim u bë pjesë e dokumentit final të analizës së tregut të telefonisë fikse të miratuar nga AKEP më 30.07.2013.

## ❖ **Rregulla dhe Udhëzime për AS/CA**

Në vijim të detyrimeve të vendosura për sipërmarrësit me FNT (operatorët celularë dhe Albtelecom) për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (AS/CA-Account Separation/Cost Accounting), AKEP gjatë vitit 2013, kreu procedurat e përzgjedhjes së konsulentit ndërkombëtar për AS/CA, duke zgjedhur një kompani britanike, dhe në qershor 2013 filloi projektin për hartimin e rregullave dhe udhëzimeve për AS/CA për sipërmarrësit me FNT. Projekti u zhvillua me sukses dhe përfshinte:

- Takime me operatorët kryesorë për hartimin e rregullave për AS/CA;
- Kryerjen e këshillimit publik më 30.10.2013-30.11.2013 të dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për zbatimin e AS/CA për sipërmarrësit me FNT në Shqipëri”
- Zhvillimin e seminarit me pjesëmarrje të AKEP dhe operatorëve kryesorë;
- Përgatitjen e dokumentit Final “Rregulla dhe Udhëzime për zbatimin e AS/CA për sipërmarrësit me FNT në Shqipëri” dhe qëndrimet ndaj komenteve të operatorëve;
- Trajnime të stafit të AKEP për AS/CA

Në përfundim të projektit, AKEP publikoi rregulloren, “Rregulla dhe Udhëzime për zbatimin e AS/CA për sipërmarrësit me FNT në Shqipëri”, i cili përcakton midis të tjerave:

- Një panoramë të politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës të Bashkimit Evropian dhe të Shqipërisë në lidhje me ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive rregullatore, dhe përcaktimet e Ligjit 9918, datë 19.05.2008;

- Përshkrimi i detajuar i metodave dhe metodologjisë mbi procesin e ndarjes së llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive nga ana e sipërmarrësve të shpallur me FNT në RSH;
- Paraqitja e pasqyrave standarte të detyrueshme për t'u mbajtur nga sipërmarrësit e shpallur me FNT në RSH;
- Një përshkrim mbi opinionin dhe raportin e auditit të pasqyrave të llogarive rregullatore.
- Fillimin e aplikimit të rregullave për vitin financiar 1.01.2014-31.12.2014 sipas kostove historike (HC) dhe alokimi i plotë i kostove (FAC), dhe për vitet në vijim sipas kostove aktuale (CC-Current Cost) dhe LRIC.

### **3. Masa për mbrojtjen e konsumatorit dhe përdoruesve fundorë**

Në vijim të masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit në vitin 2012, AKEP gjatë vitit 2013 kreu këshillim publik për Rregulloren për termat përgjithshme të kontratës së pajtimit. AKEP me vendim nr.2405, datë 26.12.2013, miratoi rregulloren për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit, e cila synon të standartizojë termat e përgjithshme të kontratave të hartuara nga sipërmarrësit për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, duke lehtësuar mundësinë e krahasimit të tyre nga përdoruesit fundorë/konsumatorët.

### **4. Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës**

Autoriteti i Konkurrencës (AK) me shkresën nr.38, datë 25.01.2014 ka dërguar në AKEP Vendimin nr.303, datë 16.01.2014, "Për Mbylljen e Hetimit të Thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania sh.a dhe rekomandime për AKEP", vendim i publikuar edhe në faqen e internetit të AK. Vendimi nr.303, datë 16.01.2014 është marrë në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar të nisur nga AK me Vendimin nr. 275, datë 25.03.2013, "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë". Nëpërmjet vendimit AK ka përcaktuar se Vodafone Albania ka pasur pozitë dominuese në periudhën 2011-2012 por nuk ka abuzuar me këtë pozitë. AK ka vendosur mbylljen e hetimit të thelluar duke dhënë disa rekomandime për AKEP. AKEP ka bashkëpunuar me AK gjatë gjithë kësaj kohe, nëpërmjet dërgimit të informacioneve të kërkuara nga AK, zhvillimit të takimeve në nivel ekspertësh për procedurat e nisura nga AK si dhe dërgimit të opinionit të ekspertëve për raportin e hartuar nga grupi i punës së AK për hetimin e thelluar.

AKEP siç është cituar në seksionet e mësipërme me Vendimet nr.2341-2345, datë 13.03.2014 miratoi dokumentacionin final për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, duke vendosur për reduktime të mëtejshme të tarifave të terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë. Nëpërmjet këtij dokumenti AKEP është munduar të adresojë edhe problematikën e referuar nga operatorët si dhe komentet e tyre në këshillim publik. Qëllimi i rishikimit është përmbushja e objektivave rregullatore për nxitjen e konkurrencës në treg dhe maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve nga shërbimet celulare.

Ndërkohë AKEP me Urdhërin e Brendshëm nr.1119, datë 17.03.2014, ka ngritur një Grup Pune për kryerjen e procedurës së analizës së tregut celular, e cila do trajtojë në mënyrë më të detajuar problematikën e shfaqura.

### **3. VEPRIMTARIA PËR ADMINISTRIMIN E SPEKTRIT TË FREKUENCAVE, NUMERACIONIT, VLERËSIMIT TË CILËSISË DHE ADMINISTRIMIT DOMAIN.AL**

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP-it është administrimi i burimeve natyrore të fundme (spektri i radiofrekuencave dhe numeracioni), vlerësimi i cilësisë së rrjeteve, shërbimeve dhe pajisjeve fundore të radiokomunikimit, si dhe administrimi i domain.al dhe nën domain-eve të tij. Kjo veprimtari bazohet në kompetencat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008, sipas të cilave për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë të përcaktuara nga ky ligj AKEP-i ka kompetencë:

- Bashkëpunon me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
- Përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga AMA;
- Lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave;
- Kryen procedurat e përcaktuara, sipas këtij ligji, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës;
- Bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron;
- Harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- Cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Administron domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe ENUM;
- Kryen njohjen e konformitetit për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve;
- Siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit;
- Merr masat që, sipërmarrësit të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme;
- Krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t'i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit.

Mbulimin e kësaj veprimtarie e kryen Drejtoria e Rregullimit Teknik.

Në zbatim të këtyre kompetencave dhe detyrave ligjore, Drejtoria e Rregullimit Teknik gjatë vitit 2013 ka kryer këtë veprimtari:

#### **➤ Bashkëpunimi me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave:**

AKEP ka dhënë kontributin e tij maksimal me pjesëmarrjen në grupin ndërinstitucional të ngritur për përgatitjen e Planit Kombëtar të Frekuencave. Ky plan ka implementuar ndryshimet e pasqyruara në ECA planin e publikuar në shkurt të 2013 (The European Table of Frequency Allocations and Applications in the Frequency) dhe është miratuar me VKM nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave.

➤ **Përgatitja e Planit të Përdorimit të Frekuencave dhe administrimit të brezave të frekuencave të caktuara për qëllime civile:**

AKEP për të studiuar mënyrën e implementimit të ndryshimeve të ndodhura në PKF në Planin e Përdorimit të Frekuencave ngriti një grup pune. Në përfundim grupi i punës bëri propozimet përkatëse dhe AKEP me Vendimin Nr.2418, datë 06.02.2014 miratoi Planin e Përdorimit duke bërë të mundur:

- Teknikisht dhe ekonomikisht planifikimin optimal, caktimin dhe përdorimin efikas të frekuencave, duke marrë parasysh që spektri i radiofrekuencave dhe orbita gjeostacionare janë në vetëvete burime të rralla dhe të fundme;
- Përfitim të kushteve për përgatitjen e rregullave mbi kushtet teknike dhe operative për përdorimin e disa frekuencave;
- Mbrojtjen nga interferencat e dëmshme;
- Rregullimin e Planit me modifikimet në nivel ndërkombëtar, si edhe bashkërendimet që rezultojnë nga përmbushja e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me fqinjët dhe vendet e tjera;
- Rregullimin e përdorimit të brezave të frekuencave ndërmjet shërbimeve radio dhe përdoruesve;
- Implementimin e teknologjive të reja dhe zhvillimin e komunikimeve radio.

Ky Plan Përdorimi i frekuencave përfshin:

- a) brezat e frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për përdorime “civile”, të cilat mund të përdoren për qëllime civile, si dhe zbatimet e shërbimeve radio të përcaktuara në këto breza frekuencash;
- b) rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e punës lidhur me operimin e radio sistemeve;
- c) Implementimin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë pësuar brezat GSM, IMT, BWA, etj. Përsa i përket teknologjive të aplikuara në këto breza ashtu edhe shërbimeve të ofruara.

➤ **Lëshimi i autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave:**

AKEP ka punuar vazhdimisht për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të Autorizimeve Individuale. Për këtë ka informatizuar sistemin e aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuencë dhe për numra. Këshilli Drejtues miratoi aktet rregullatore “Rregullore për Autorizimin Individual” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për caktim dhe përdorim të numrave dhe serive numerike dhe PKN” duke bërë të mundur dhe implementimin e procesit “Aplikim Online” për kërkesat e caktimit të frekuencave, caktimit të numrave dhe raportimin e interferencave. I gjithë procesi ka kaluar nëpërmjet këshillimit publik dhe takimeve e workshop-eve me sipërmarrësit.

- Nga fillimi i vitit 2013, për operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP:

- a) 42 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 421 lidhje fikse të reja/ndryshuara, nga të cilat:

VFAL	-	4	(60 lidhje të reja, 76 ndryshime, 18 revokime)
AMC	-	7	(20 lidhje të reja, 28 ndryshime, 24 revokime)
PLUS	-	4	(6 lidhje të reja, 90 ndryshime, 2 revokime)
Albtelecom	-	4	(1 LTE test, 62 lidhje të reja, 22 ndryshime, 73 revokime)
Të tjera	-	14	(55 lidhje të reja, 2 ndryshime, 20 revokime)

- b) 42 Atuorizime Individuale për përdorimin e frekuencave në 89 sisteme PMR radiokomunikim dhe radioalarmi.

Ndryshimi në numrin e autorizimeve të lëshuara dhe të revokuara në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 ka ndodhur përveç të tjerash edhe për shkak të evoluimit të rrjeteve të komunikimit pa tel që mbështesin shërbimet dhe aplikimet e reja broadband nëpërmjet:

- ofrimit të mundësive të reja për ndërtimin e një infrastrukture të integruar të rrjeteve pa tel dhe fibrave optike dhe
- rritjes së kapaciteteve të transmetimit për lidhjet ekzistuese etj.

➤ **Kryerja e procedurave të përcaktuara, sipas ligjit, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës:**

Me qëllim të shfrytëzimit sa më efektiv të spektrit dhe me kujdesin që të ofrojë shërbime me cilësi dhe me çmime konkurruese për konsumatorin AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2370, datë 18. 10. 2013 miratoi për këshillim publik dokumentin “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz dhe 2110 – 2170 MHz, brezi - IMT”. Periudha e këshillimit ka përfunduar dhe AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi po ndjek të gjitha procedurat e duhura deri në përfundimin të tij.

Gjithashtu me Vendimin Nr.2413, datë 27.01.2014 Këshilli Drejtues i AKEP ka nisur këshillimin publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800”.

➤ **Bashkëndimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron:**

AKEP këto vitet e fundit ka shtuar të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur nënshkrimin e marrëveshjeve teknike me qëllim koordinimin ndërkufitar. Kryesisht është punuar për arritjen e marrëveshjeve të koordinimit për sistemet GSM/DCS1800 për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare. Deri tani janë realizuar marrëveshjet me Autoritetin e Kosovës dhe të Malit të Zi. Është në proces dhe pritet të përmbillet së shpejti edhe marrëveshja me autoritetin Maqedonas ndërkohë që kanë filluar komunikimet në nivel teknik edhe me autoritetin homolog Grek.

➤ **Hartimi, miratimi dhe administrimi i Planit Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë:**

Me vendimin nr.2350, datë 13. 09. 2013 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi ndryshimet në Planin Kombëtar të Numeracionit. Këto ndryshime konsistojnë në kalimin e PKN nga organizimi në një numër të madh zonash gjeografike në 12 rajone gjeografikë me synimin që më vonë të kalohet në një zonë të vetme gjeografike.

Procesi ka kaluar nëpërmjet këshillimit publik me sipërmarrësit dhe takimeve e workshopeve me to. AKEP në këtë proces është asistuar nga ITU. Duhet theksuar se procese të tilla ndryshimi janë shumë komplekse, reformuese, gjithëpërfshirëse etj, dhe implementimi i tyre

kërkon një vëmendje shumë të madhe. Aktualisht jemi tre muaj pasi ndryshimet kanë hyrë në fuqi dhe konstatohet se çdo gjë po funksionon në normalitet të plotë. Ky proces përveç të tjerash është shoqëruar edhe me një fushatë publicitare dhe sqaruese të kryer nga AKEP dhe sipërmarrësit.

➤ **Caktimi i numrit dhe serive numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike:**

Aplikimi për numrat dhe seritë numerike është pothuaj i automatizuar duke eliminuar kështu thuajse të gjitha procedurat ndërmjetëse administrative që zgjasnin këtë proces. Është ngritur sistemi i menaxhimit të Planit të Numeracionit që përfshin të gjithë kategoritë e numrave dhe matricën e ndërfaqur online. Gjatë viti 2013 janë përpunuar dhe procesuar:

- Alokime numra dhe seri numerike trajtuar 66 aplikime.
- Anullim numeracioni trajtuar 20 aplikime.

➤ **Administrimi domain cc.TLD.al, nën domain-et e tij, si dhe ENUM:**

Gjatë vitit 2013 u realizua kalimi nga sistemi Regjistër-Regjistrues. Me Vendimin nr.2252, datë 23.01.2013 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”. Këto ndryshime liberalizuan tregun e regjistrimit të domain nën .al duke kaluar nga sistemi Registry-Registar vetëm AKEP në sistemin Registry AKEP dhe regjistrari i liberalizuar duke i dhënë të drejtën e regjistrimit edhe subjekteve të tjera të certifikuar nga AKEP bazuar në kriteret e vendosura në këtë dokument rregullator. Ky proces realizua nëpërmjet këshillimit publik me sipërmarrësit.

Procesi u konkretizua me çertifikimin e 5 subjekteve si regjistrues të cilët janë:

- a) Albtelecom sh.a.
- b) Keminet shpk
- c) ShqiperiaCom shpk
- d) Studio Driar
- e) Webhost shpk

Ka vazhduar procesi i regjistrimit të domain-eve nga AKEP në zonën .al duke plotësuar funksionin e regjistruesit.

- Nr. i domain-eve të regjistruar për vitin 2013 është **3320**, dhe kemi **12888** domain-e të regjistruar në total.
- Është bërë menaxhimi dhe mirëmbajtja e root server-ave të .al, procesimi i aplikimeve kryesisht për regjistrim dhe modifikim teknik në përputhje me Rregulloren nr.2 Për Regjistrimin e domain-eve nën zonën .al dhe nën domain-eve .gov.al, .edu.al, .org.al, .com.al, .mil.al, .net.al.

Më poshtë jepet një tabelë e domain-eve të regjistruar sipas zonës .al dhe nën zonave, duke bërë dhe krahasim midis viteve. Siç shihet vazhdon rritja me përqindje të lartë nga viti në vit për regjistrim e domain-eve në .al. kështu për vitin 2013 kemi patur një regjistrim prej 1139 domain-esh më shumë krahasuar me domain-et e regjistruar gjatë vitit 2012.

<i>Domain</i>	<i>Domain të regjistruar r 1998-2009</i>	<i>Domain të regjistruar deri 2010</i>	<i>Domain të regjistruar deri 2011</i>	<i>Domain të regjistruar deri 2012</i>	<i>Domain të regjistruar deri 2013</i>

.al	1182	3912	6200	8334	11466
.com.al	309	435	544	630	748
.gov.al	160	192	273	301	337
.org.al	93	93	116	134	165
.edu.al	75	81	124	133	129
.net.al	12	18	23	28	35
.mil.al	8	8	8	8	8
Total	1893	4793	7387	9568	12888

AKEP në bashkëpunim me minsitrinë dhe NJMLF-në ka ndjekur vazhdimisht procesin e bllokimit nga ana e ISP-ve të faqeve elektronike të lojrave të fatit online të palicencuara

➤ **Njohja e konformitetit për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve:**

AKEP mbështetur në përcaktimet e ligjit 9918, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave për “Rregullat teknike për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve” gjatë vitit 2013 ka trajtuar 30 aplikime për pajisje me certifikatë konformitet të pajisjeve radio.

➤ **Sigurimi i disponueshmërisë së bazës qendrore të të dhënave për portabilitetin e numrit:**

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB.

Në përgjithësi procesi ka ecur mirë, edhe këtë vit ka patur një numër të madh abonentësh të cilët kanë përdorur shërbimin e portabilitetit të numrit, një tablo me shifrat e numrave të bartur në fund të viteve 2012 dhe 2013 paraqitet si më poshtë:

Shërbimi Telefonik	I lëvizshëm		Fiks	
	2012	2013	2012	2013
Numra të bartur	97173	101622	34	4875

Sipas të dhënave të CRDB (bazës së të dhënave të këtij sistemi) rezulton një shifër prej afro 5000 numrash fiks të bartur.

AKEP ka kryer një këshillim publik mbi performancën e bazës së të dhënave me të gjithë sipërmarrësit e tregut të komunikimeve elektronike. Në përfundim të këshillimit rezultoi se performanca ishte e kënaqshme. Aktualisht sapo ka nisur një proces tjetër këshillimi me sipërmarrësit lidhur me disa ndryshime që propozohet ti bëhen Rregullores së Portabilitetit të Numrit për të shmangur në minimum rastet e pezullimit ose zgjatjeve të konstatuara në procesin jes.

➤ **Marrja e masave që sipërmarrësit të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashëtzakonshme:**

Përveç të tjerave, AKEP, duke e parë si një çështje mjaft të rëndësishme sigurinë publike, ka propozuar disa ndryshime në Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm, të cilat janë në këshillim publik dhe pritet të miratohen së shpejti. Ndryshimet konsistojnë në detyrimin e

sipërmarrësve për të njoftuar në AKEP për rrijetet dhe/ose shërbimet që kërkojnë të ofrojnë dhe masat e marra për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre.

➤ **Krijimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i bazës së të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike:**

*AKEP ka përmirësuar infrastrukturën si dhe ka rritur sigurinë e sistemeve të I.T. -së*

Aktualisht AKEP ka të ngritur një sistem informatik të avancuar ku të gjithë drejtoritë e AKEP për të kryer detyrat funksionale përdorin këto sisteme për të menaxhuar të dhënat. U pa i nevojshëm zgjerimi i kapaciteteve egzistuese informatike, të kabinetit informatik dhe gjithashtu përmirësimi i menaxhimit të sistemeve informatike në platforma tërësisht të sigurta për ruajtjen e disponueshmërisë të shërbimeve dhe të të dhënave, si për administratën ashtu edhe për përdoruesit e tjerë të shërbimeve të AKEP. Është zgjedhur virtualizimi si një nga teknologjitë që ka aftësinë për të përmirësuar proceset e kryerjes së punëve dhe shërbimeve si dhe rritjen e efikasitetit duke ofruar disponueshmëri më të madhe. Projekti është në fazën e implementimit. Janë pajisur punonjësit e AKEP me resource Hardware dhe Software duke vazhduar përmirësimin e kushteve të I.T.

Gjithashtu është bërë instalimi i Sistemeve të analizimit të të dhënave dhe i sistemeve të filtrimit të rreziqeve që vijnë nga interneti dhe nga website të caktuara.

*Është ngritur sistemi i ankimeve të përdoruesve (user complain system)*

Ky sistem do të ndihmojë AKEP të adoptojë një fokusim ndaj publikut në zgjidhjen e ankesave dhe do të inkurajojë personelin të përmirësojë aftësitë e tyre në punën me publikun. Sistemi online të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të komunikimit të AKEP realizon funksionet e mëposhtme:

- Marrjen dhe regjistrimin e ankesave për cilësinë e shërbimeve dhe të denoncimit të praktikave të papërshtatëshme në ofrimin e shërbimeve nëpërmjet një linje telefonike të dedikuar, me E-Mail, SMS, nëpërmjet Faqes Elektronike të AKEP ([www.akep.al](http://www.akep.al)) etj.
- Ruajtjen dhe përpunimin e ankesave dhe informacionit të marrë nëpërmjet Sistemit Online të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Komunikimit dhe adresimi i tyre për kompetencë.
- Monitorimin dhe ndjekjen e procesit të përgjigjeve ndaj ankesave.
- Gjenerimin e raporteve lidhur me numrin dhe tipin e ankesave dhe kohën mesatare për zgjidhjen e tyre.

Sistemi ofron mundësinë e kthimit të përgjigjes tek klienti për rezualtatin e ankesës dhe investigimin apo masat e marra.

*Janë monitoruar treguesit e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme.*

AKEP, përveç të tjerash ka kryer monitorime për cilësinë e mbulimit me shërbim edhe në akset kryesore dhe zonat turistike si më poshtë:

- Qyteti Vlorë dhe zonat turistike Svernec, Radhimë Orikum, Llogara.
- Zonat turistike Dhërmi, Vuno, Jalë, Himarë, Allaman, Qeparo, Borsh, Lukovë
- Qyteti Sarandë, Ksamil dhe zonat turistike Butrint, Syri kaltër. Dogana Qafbotë Qytetet Delvinë dhe Gjirokastrë. Dogana Kakavijë.

*Është ngritur sistemi “Disaster recovery site”*



Për të siguruar sistemet dhe informacionin e rëndësishëm në:

- Server-a në përdorim për shërbime dhe aplikacione si: Domain Controller, Exchange Server, DMS, ATLAS, Aplikimet Online, Backup, Storage,
- Sistemi i Monitorimit të GSM/UMTS, SMS4Dc etj.
- Sistemi i menaxhimit të domain .al dhe root server-at i cili përbëhet nga 10 server-a me role si NameServer, DB , aplikacioni dhe nderfaqja Whois dhe Storage.
- Pajisje rrjeti si switche, router dhe firewall.

dhe për të bërë të mundur vazhdimësinë e shërbimit në raste të dëmtimit ka filluar puna për krijimin e nje backup site, **ngritja e “Disaster recovery site”**.

Është zhvilluar gara për këtë objekt, aktualisht është bërë lëvrimi i pajisjeve hardware dhe licençave përkatëse dhe projekti është në fazën e implementimit.

### ***Përfundoi faza e dytë e Projektit ATLAS***

Objektivi i projektit ishte integrimi në një sistem Web-Gis i informacioneve hapësinore dhe jo hapësinore të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike :

- sistemeve të transmetuesve të radio frekuencave
- sistemeve për infrastrukturën e komunikimeve elektronike
- Integrimi i të gjithë informacioneve të infrastrukturës së komunikimeve elektronike në një sistem Web-GIS i cili krijon mundësinë institucionit në një vendim-marrje të shpejtë mbi politikat e menaxhimit, monitorimit, kontrollit, raportimit etj.

Programi i hartuar është i konceptuar si një sistem multipërdoruesish, duke u ofruar kështu mundësinë administratorëve të sistemit një menaxhim efikas, ndarje të roleve dhe detyrave të përdoruesve, përditësim dhe zgjerim të funksionaliteteve në të ardhmen.

### ***Sistemi perfshin:***

- Hartën e infrastrukturës së rrjetit: Kabëll Bakri (sipas operatorëve)
- Hartën e infrastrukturës së rrjetit: Fibër Optike (sipas operatorëve)
- Hartën e infrastrukturës: Bazament Antene (sipas operatorëve)
- Hartën e infrastrukturës së rrjetit: Radio (sipas operatorëve)
- Hartën e monitorimit të cilësisë së shërbimit (GSM, WCDMA, sipas operatorëve)
- Popullimi i shtresës Foto Atlasi në aplikimin ATLAS, me foto të ndryshme të antenave si dhe objekte të tjera me specifikime dhe informacione të detajuara.
- Moduli i raporteve të ndryshme për administratorët e sistemit.

Bazuar në të dhënat e administruara nga ky sistem rezulton rreth 3,235,589 m kabëll fibër optike e shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Për sipërmarrësit kryesorë të dhënat jepen në tabelën e mëposhtme:

<b>Spërmarrësi</b>	<b>Gjatësia Kabëll Optik (m)</b>
<b>Abissnet</b>	151,705.60
<b>Keminet</b>	14,838.90

<b>Abcom</b>	239,631.20
<b>Nisatel</b>	129,112.50
<b>ATU</b>	751,862.30
<b>Plus</b>	1,087.50
<b>Albtelekom</b>	1,409,447.10
<b>Primo</b>	230,302.30
<b>ITirana</b>	91,894.70
<b>Tring</b>	68,949.70
<b>Itel</b>	146,757.20

Moduli bën të mundur krijimin e hartave të prognozimit të përhapjes së sinjalit të përdorur nga operatorët që operojnë në vendin tonë, duke u bazuar në modelet më të përparuara të rekomanduara nga ITU, ITU-R REC P.526, ITU-R REC P.530, ITU-R REC P.1546

## **5. VEPRIMTARIA E INSPEKTIMIT DHE MONITORIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE SI DHE MASAT ADMINISTRATIVE:**

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Detyrat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit dhe monitorimit të spektrit si dhe vendosja e masave administrative kryhen nga Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit të Frekuencave

### **➤ Inspektimi:**

Sektori i inspektimit në përbërje të drejtorisë, në zbatim të planit vjetor dhe planeve një-mujore të miratuara nga KD i AKEP në vitin 2013 **ka kryer gjithsej 43 inspektime** tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të përgjithshëm. Nga këto inspektime 41 janë bërë sipas planit vjetor të miratuar dhe dy inspektime jashtë planit sipas ankesave të bëra nga dy sipërmarrësit e komunikimeve elektronike “Enkelana Communication” Sh.p.k dhe “Alma 2001” Sh.p.k.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se 32 sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm, dhe 6 sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë sipas ligjit material Nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar. Po ashtu, nga inspektimet e realizuara u konstatua se nuk ushtronin aktivitet të komunikimeve elektronike sipërmarrësit “Erald Shegani” (Person Fizik) dhe “Futuro Comunicazione” Sh.p.k, pasi kishin kaluar në status pasiv. Ndërsa sipërmarrësi “DEVI-ERI” Sh.p.k ofronte vetëm shërbimin e televizionit kabllor. Shërbimin e internetit nuk kishte filluar ta ofronte për përdoruesit e tij pasi ishte në fazë implementimi të pajisjeve të cilat bëjnë të mundur ofrimin e këtij shërbimi.

Objekti i inspektimeve sipas planit vjetor ka qenë:

1. Verifikimi i zbatimit të Rregullores për treguesit e cilësisë së shërbimit, miratuar me Vendimin nr. 1256, dt.16.04.2010, të Këshillit Drejtues”.
2. Verifikimi i zbatimit të Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve“ miratuar me Vendimin nr.2161, datë 21.09 2012, të Këshillit Drejtues të AKEP-it.
3. Verifikimi i paisjeve dhe aparaturave me certifikatën e konformitetit.
4. Verifikimi i zbatimit të kushteve të Autorizimit.
5. Plotësimin e detyrimeve kundrejt AKEP.

Grupi inspektimit në vijim të punës së tij, në çdo inspektim të sipërmarrësve të

komunikimeve elektronike ka vepruar sipas një plani veprimi si më poshtë vijon:

Qëllimi i shfrytëzimit të Autorizimit nga sipërmarrësit.

- Përdorimi i kapaciteteve të komutimit dhe transmetimit, marrë nga sipërmarrësit e tjerë të autorizuar nga AKEP.
- Llojet e shërbimeve që ofron aktualisht sipas kushteve të përcaktuara në Autorizim.
- Detyrime të shtrirjes së rrjetit dhe ofrimit të shërbimeve bazë të komunikimeve elektronike sipas Autorizimit.
- Instalimi i telefonave publikë.
- Verifikim i implementimit të numrave të shkurtuar të emergjencës pa pagesë për përdoruesit e tij.
- Verifikim i përdorimit të frekuencave dhënë sipërmarrësit.
- Ankesat që mund të ketë në interferimin e frekuencave.
- Shërbim i pandërprerë 24 orë, verifikim i burimeve të ushqimit rezervë.
- Verifikimi treguesve të cilësisë së shërbimit.
- Sigurimi i shërbimeve të informacionit dhe botimi i numeratorit telefonik.
- Bashkëpunimi me sipërmarrësin publik të komunikimeve për përfshirjen e përdoruesve të tij në shërbimet e informacionit.
- Verifikimi i realizimit të shërbimeve ndërrubane dhe ndërkombëtare.
- Publikimi i tarifave të instalimit dhe shërbimeve që ofron sipërmarrësi.
- Verifikimi i detyrimeve financiare që ngarkon sipërmarrësi përdoruesit, në raport me ato të publikuarat.
- Verifikimi i furnizimit të përdoruesit me faturë mujore në formë të përmbledhur ose të detajuar.
- Verifikimi i kontratës të lidhur midis sipërmarrësit dhe përdoruesit në përputhje me dispozitat ligjore, e njehsuar me kontratën tip të miratuar më parë në AKEP.
- Njohja me ankesat e bëra nga përdoruesit, evindentimi, mënyra dhe afati kohor i zgjidhjes së tyre.
- Verifikimi i lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit me sipërmarrësin Albtelecom dhe sipërmarrës të tjerë të autorizuar të komunikimeve.
- Verifikimi konkret i aktivizimit të kod aksesit NDC dhe bllokut të numrave SN të dhënë nga AKEP, të veçantë për çdo komunë, sipas përcaktimit të bërë në Autorizim.
- Verifikim i shlyerjes së detyrimeve financiare vjetore brenda afatit:
- Mënyrën e realizimit të rrjetit të sipërmarrësit. Verifikimi i pajisjeve dhe aparaturave që sipërmarrësi përdor në rrjetin e saj, nëse ato janë të paisura me certifikatë konformiteti të miratuar në AKEP.
- Verifikim i garantimit të shërbimit të pandërprerë 24 orë nga sipërmarrësi.
- Verifikimi i normave teknike për shërbimin internet që ofrohet nga sipërmarrësi.
- Plotësimi i tabelës me të dhënat statistikore nga sipërmarrësi.
- Verifikimi i domainit kryesor .al
- Verifikim i marrëveshjes me sipërmarrësin nga e merr aksesin internet.
- Verifikimi nëse sipërmarrësi ka dorëzuar në AKEP informacion statistikor.
- Verifikimi i frekuencave të dhëna për përdorim nga AKEP kur sipërmarrësi përdor pajisje radio në rrjetin e saj.
- Verifikimi i instalimit të matësit të shpejtësisë së aksesit në internetit.

### **Inspektimet që janë bërë jashtë planit vjetor:**

Në muajin tetor në bashkëpunim me specialistë të Drejtorisë Teknike, sektori i inspektimit ka kryer një Urdhër verifikimi në zonën e Maqellarës, Dibër sipas ankesës së bërë nga sipërmarrësi i komunikimeve elektronike "Alma 2001" Sh.p.k, dhe një Urdhër verifikimi në Buçimas të qytetit Pogradec sipas ankesës së bërë nga sipërmarrësi "Enkelana Communication" Sh.p.k për konkurrencë të pandershme në zonat, ku këto sipërmarrës ofronin shërbimet e tyre. Pas verifikimeve të bëra në zonën e Maqellarës (Dibër), dhe në Buçimas,

Pogradec, u konstatua se kompani maqedonase ofrojnë akses në internet brenda territorit të Shqipërisë. Për këto arsye, AKEP i është drejtuar Angjensisë të Komunikimeve Elektronike të F.Y.R të Maqedonisë, për ndërprerjen e menjëhershme të sinjalit dhe shërbimit internet të kompanive maqedonase që japin akses në zonën e Maqellarës, Dibër, dhe Bucimas, Pogradec.

**Gjatë këtyre inspektimeve** bazuar në nenin 137 të ligjit material nr.9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nenit 24 të Rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”, miratuar me VKD nr.1516, datë 31.01.2011, për 6 sipërmarrës të komunikimeve elektronike u vendos masë administrative me gjobë për shkelje të cilat janë pasqyruar në aktet e inspektimit. Të 6 (gjashtë) këto masa administrative (gjobë) janë arkëtuar në llogari të AKEP dhe janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme – Sektorin e Financë Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Licencimit janë kryer veprime lidhur me ndjekjen e debitorëve ndaj AKEP.

#### ➤ **Monitorimi i spektrit të frekuencave:**

Spektori i monitorimit të spektrit në përbërje të drejtorisë, i angazhuar për të përmbushur detyrat sipas planeve mujore, të hartuar në bazë të objektivave për vitin 2013 ka kryer:

1. Monitorimin e radiofrekuencave për linket (lidhjet pikë më pikë) në pikat kryesore të transmetimeve - gjithsej të realizuara 15 (pesëmbëdhjetë).
2. Verifikimin e ankesave për interferenca në frekuencat e punës - gjithsej të realizuara 25 (njëzet e pesë). Nga këto:
  - Verifikim i ankesave për interferenca për operatorët celular në frekuencat e sistemit GSM/UMTS - gjithsej të realizuara 13 (trembëdhjetë).
  - Verifikim i ankesave për interferenca për operatorët celular në frekuencat e linkeve (lidhjet pikë më pikë) - gjithsej të realizuara 5 (pesë).
  - Verifikim i ankesave për interferenca në pajisjet e radiokomunikimit për operatorët SH.R.S.F., (shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike) që operojnë në brezat VHF dhe UHF - gjithsej 4 (katër).  
Nga verifikimi i ankesave për interferenca për operatorët SH.R.S.F., janë bllokuar pajisjet e radiokomunikimit për 1 (një) rast.
  - Verifikim i ankesave për interferenca në frekuencat e punës për raste të tjera - gjithsej 3 (tre). Pothuajse për të gjitha rastet e interferencave në frekuencat e punës janë gjetur burimet e tyre dhe është bërë e mundur eliminimi i tyre.
3. Monitorimin e brezit 3.4-3.8 GHz. Janë bërë matje në shtatë qytete të ndryshme.
4. Fotografimin e antenave të kullave në pikat kryesore të transmetimeve - gjithsej 32 (tridhjetë e dy), në funksion të të dhënave për Atlas-in.

Në bashkëpunim me AMA-n, janë kryer matje në 66 zona gjeografike për monitorimin e transmetuesve televiziv.

## 6. VEPRIMTARIA PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE:

Në kompetencat ligjore të AKEP-it përfshihet edhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918/2008. Procesi i kryerjes së hetimit në kuadër të procedimit administrativ në rastet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve dhe paraqitjes së raportit për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues, si dhe procedura e trajtimit të ankimeve administrative dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis pajtimtarit dhe sipërmarrësit kryhet nga Drejtoria Juridike.

### ➤ Lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve:

Gjatë vitit 2013, në rastet kur nga AKEP-i është investuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve dhe Drejtoria Juridike në varësi të problematikës, objektit në bashkëpunim me Drejtorinë e Rregullimit Ekonomik dhe Teknik, është angazhuar në ndjekjen e procedimeve administrative:

#### 1. Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Abcom sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.:

- Vendimi nr. 2326, datë 28.6.2013, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abcom sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”
- Palët kanë rënë dakort për implementimin e tarifave sipas shkresës së Abcom sh.p.k. me nr. 211Prot., datë 19.7.2013, me objekt “*Tërheqje ankimi*”.

#### 2. Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.:

- Vendimi nr. 2327, datë 28.6.2013, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”
- Vendimi nr. 2369, datë 10.10.2013, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2327, datë 28.06.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

#### 3. Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.:

- Vendimi nr. 2354, datë 27.9.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Albtelecom sh.a. drejt abonentëve të Vodafone Albania sh.a.”.

#### **4. Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a.**

Vendimi nr. 2356, datë 27.9.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave”.

#### **5. Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe AMC sh.a.:**

- Vendimi nr. 2361, datë 27.9.2013 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Albanian Mobile Communications sh.a. drejt Albtelecom sh.a.”.

#### **➤ Lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimitarit dhe sipërmarrësit:**

Në tre rastet e investimit të AKEP-it për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimitarit dhe sipërmarrësit, Drejtoria Juridike ka trajtuar praktika të ankesave për “mosmarrëveshje midis pajtimitarit dhe sipërmarrësit”, në kuadër të pjesëmarrjes në Komisionin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve:

- Person fizik (**pajtimitari**) kundër Albtelecom sh.a (**sipërmarrësi**), datë 14.10.2013 ;
- Person Juridik publik (**pajtimitari**) kundër Plus sh.a (**sipërmarrësi**), datë 11.11.2013;
- Person Juridik publik (**pajtimitari**) kundër Albtelecom sh.a (**sipërmarrësi**) datë 30.12.2013.

#### **➤ Lidhur me trajtimin e ankesave administrative:**

Gjatë vitit 2013 janë paraqitur nga sipërmarrësit 6 (gjashtë) raste të ankimeve administrative kundrejt akteve të nxjerra nga AKEP-i, të cilat janë trajtuar nga Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Rregullimit Ekonomik:

1. Vendimi nr. 2358, datë 27.09.2013, të Këshillit Drejtues, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2338, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese””.
2. Vendimi nr. 2359, datë 27.09.2013, të Këshillit Drejtues, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. ndaj Vendimit nr. 2339, datë 31.07.2013 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communication sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë dhe vendosjen e masave rregulluese””.
3. Vendimi nr. 2360, datë 27.09.2013, të Këshillit Drejtues, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communication sh.a. ndaj Vendimit nr. 2339, datë 31.07.2013 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communication sh.a., me

Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik AMC drejt numrave gjeografikë dhe vendosjen e masave rregulluese”.

4. Vendimi i Këshillit Drejtues, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2305, datë 29.5.2013, “Për miratimin e dokumentit “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”.
5. Vendimi nr. 2344, datë 30.8.2013 për “Shqyrtimin e Ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. për “Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2325, datë 28.6.2013, “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. mbi disa shtesa e ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”.
6. Vendimi nr. 2357, datë 27.09.2013, të Këshillit Drejtues, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2337, datë 30.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me Fuqi të Ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në lidhje me statusin FNT në tregjet e pakicës si dhe në tregun e akses/origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare”.

➤ **Lidhur me ndjekjen e çështjeve gjyqësore:**

Pjesë e veprimtarisë së AKEP-it është edhe ndjekja e çështjeve gjyqësore në të cilat AKEP-i është palë ndërgjyqëse. Gjatë vitit 2013, janë ndjekur çështjet gjyqësore:

I. Çështje civile në proces në Gjykatën e Shkallës së Parë:

1. **Çështja civile me palë:**      **Paditës:**      **Abissnet sh.a.**  
   **I Paditur:**      **Albtelecom sh.a.**  
   **Palë e tretë:**      **AKEP**

**Objekti:**

Detyrimi për shpërblim të dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar në vlerën 20 000 000 (njëzet milion) lekë për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit nga Albtelecom sh.a.

Gjykimi ka filluar me datë 11.10.2011. AKEP është thirrur si palë e tretë me ftesë për t'u paraqitur më datë 4.10.2012.

Janë zhvilluar 19 seanca dhe gjykimi vazhdon.

2. **Çështja civile me palë:**      **Paditës:**      **AKEP**  
   **I Paditur:**      **Alfa Telecom sh.p.k.**

**Objekti:**

Detyrimin e të paditurit Alfa – Telecom sh.p.k. të përmbushë detyrimet financiare të papaguara për faturën e lëshuar nga AKEP me nr. 2414002, në shumën 2,719,728 lekë.

Gjykimi ka filluar me datë 17.4.2013. Janë zhvilluar 6 seanca dhe gjykimi vazhdon.

3. **Çështja civile me palë:**      **Paditës:**      **Info-Telecom sh.p.k.**  
   **I Paditur:**      **AKEP**

**Objekti:**

Anullimi/shfuqizimi i akteve administrative të nxjerra nga AKEP “Shkresë nr. 1404Prot., datë 14.8.2013” dhe “Shkresë nr. 1404/8Prot., datë 27.9.2013 – njoftuar paditësit më datë



1.10.2013”.

Pezullimi i zbatimit të akteve administrative të mësipërme të AKEP.

Seanca e parë është zhvilluar në datën 3.12.2013, gjykimi vazhdon

**4. Çështja civile me palë:                    Padiës:            Ilir Zela**  
**Të Paditur:    Kuvendi i Shqipërisë dhe AKEP**

**Objekti:**

Shfuqizimi i vendimit nr. 10 datë 26.11.2009 “Për lirim nga detyra të një anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë padiësin me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

Me Fletë – Thirrje nr. Akti 19496, datë 26.11.2013, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka caktuar seancën e parë më datë 23.12.2013, ku AKEP thirret si palë e paditur.

**5. Çështja civile me palë:    Padiës:            Ilir Shehu**  
**Të Paditur:    Kuvendi i Shqipërisë**  
**Palë e tretë:    AKEP.**

**Objekti:**

Shfuqizimin e Vendimit Nr. 11, datë 26.11. 2009, “Për Lirim tim nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të ERT-së” dhe rregullimin e të gjitha pasojave ligjore.

Me Fletë – Thirrje nr. Akti 19378, datë 21.11.2013 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka caktuar seancën e parë më datë 27.12.2013, ku AKEP thirret si palë e tretë.

**6. Çështja civile me palë:    Padiës:            Silvana Miho**  
**I Paditur:      Panajot Barka**  
**Palë e Tretë:    AKEP**  
**Drejtoria e Tatimeve Gjirokastrë**

**Objekti:**

Shpërblim dëmi dhe ndalim i ushtrimit të aktivitetit të ofrimit të shërbimit të internetit në kushtet e konkurrencës së pandershme.

Është zhvilluar seanca e parë më datë 4.12.2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjykimi vazhdon.

**II. Çështje civile të mbyllura në Gjykatën e Shkallës së Parë:**

**1.        Çështja civile me palë:            Padiës:            Vodafone Albania sh.a.**  
**I Paditur:      AKEP**

**Objekti:**

Konstatim të pavlefshmërisë relative të Vendimit nr. 1681, datë 8.9.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe shfuqizimin e tij si dhe detyrimin e AKEP për nxjerrjen e një akti të ri administrativ në përputhje me ligjin.

Gjykimi ka filluar më 7.12.2011, dhe janë zhvilluar gjithsej 9 seanca gjyqësore.  
**Më datë 11.2.2013, Gjyqtarja vendosi pushimin e çështjes, për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse Vodafone.**

2. **Çështja civile me palë: Paditës: Pronet sh.p.k.  
I Paditur: AKEP**

**Objekti:**

1. Konstatim i pavlefshmërisë (*absolute*) të aktit administrativ: Vendim nr. 404, datë 18.10.2007 të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe anulimin e pjeshëm (pikës 1 dhe pikës 2) të Faturës nr. 34, datë 20.8.2008 të nxjerrë nga AKEP.
2. Vendosjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar deri në fund të procesit gjyqësor procedurat e arkëtimit të detyrimit prej 3 720 000 lekë të përcaktuar në Faturën nr. 34, datë 20.8.2008 të AKEP.

Gjykimi ka filluar më datë 8.2.2013. Janë zhvilluar gjithsej 8 seanca. **Më datë 1.11.2013 Gjykata shpalli vendimin: Rrëzimin e kërkesë padisë.**

**III. Çështje civile të mbyllura në Gjykatën e Apelit Tiranë:**

1. **Çështja civile me palë: Paditës: Ilir Zela  
Të Paditur: Kuvendi i Shqipërisë dhe AKEP**

**Objekti:**

Shfuqizimi i vendimit nr. 10 datë 26.11.2009 “Për lirimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;  
Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

Gjykata e Shkallës së Parë më datë 21.6.2012, vendosi: **Rrëzimin e kërkesë padisë.  
Kundër këtij vendimi Ilir Zela ka bërë apelim.**

Gjykata e Apelit më datë 2.10.2013, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve u tërhoq dhe më pas shpalli vendimin për: **Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë me një tjetër trup gjykues.**

2. **Çështja civile me palë: Paditës: Ilir Shehu  
I Paditur: Kuvendi i Shqipërisë dhe AKEP.**

**Objekti:**

Shfuqizimin e Vendimit Nr. 11, datë 26.11. 2009, “Për Lirimin tim nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të ERT-së” dhe rregullimin e të gjitha pasojave ligjore.

Pas kthimit të çështjes, gjykimi ka rifilluar në shkallë të parë më 5.12.2011, dhe janë zhvilluar gjithsej 7 seanca gjyqësore.

**Gjykata e shkallës së parë më datë 3.12.2012, shpalli: Pushimin e gjyqimit.  
Kundër këtij vendimi Ilir Shehu ka bërë apelim.**

Gjykata e Apelit më datë 13.9.2013, pasi dëgjoji shpjegimet e palëve u tërhoq dhe më pas shpalli vendimin për: **Rikthimin e çështjes për gjykim në shkallë të parë me të njëjtin trup gjykues.**

## 7. ASPEKTE TË TJERA TË VEPRIMTARISË:


Në zbatim të Ligjit Nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuar me ligj” i ndryshuar, dhe Vendimit të Kuvendit nr. 97, datë 30.04.2007, të ndryshuar, është miratuar struktura organizative dhe organika e ERT-së, (AKEP), strukturë që është në fuqi, të punonjësve me 60 vetë. Me këtë strukturë AKEP ka funksionuar dhe në vitin 2013.

Duke qënë se:



- struktura dhe organika e AKEP (ish-ERT) është miratuar para ligjit 9918, ekzistojnë vështirësi në punën e përditëshme gjatë implementimit të kësaj strukture;
- funksionet rregullatore postare nga Ministri i linjës kanë kaluar në AKEP në bazë të ndryshimeve të Ligjit nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”;
- janë shtuar detyrimet ligjore me ndryshimet e ligjit 9918; si dhe

me qëllim rritjen e fleksibilitetit, efektivitetit dhe transparencës së ofrimit të shërbimeve nga AKEP, është domosdoshmëri miratimi i një strukture dhe organike të re.

Përbërja strukturore e punonjësve të AKEP jepet në grafikët e mëposhtëm:



## Të punësuar gjithsej (60)



Duke qenë se AKEP është një institucion që mbikqyr sektorë shumë të specializuar siç janë ato të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit. Gjatë vitit 2013, është shfrytëzuar çdo mundësi trajnimi financiar nga fondet e AKEP, të organizatave ku vendi yne është anëtar dhe kontribues si dhe të institucioneve homologe.

Trajnimet e kryera janë bazuar në domosdoshmërinë e rritjes të kapaciteteve administrative dhe profesionale si dhe përmbushjen e objektivave të AKEP.

Nr.	Aktiviteti	Institucioni Organizues
1.	Takim ndërmjet AKEP dhe EKIP për planifikimin dhe koordinimin e frekuencave të brezit E-GSM, GSM 900 dhe DCS 1800 në zonat kufitare	EKIP
2.	Forumi i projektit të Komisionit Evropian mbi monitorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit në vendet në zhvillim	Cullen International në bashkëpunim me ICTA
3.	Seminar Evropian "Financimi i BE për Projektet e Infrastrukturës së Broadband"	Akademia Evropiane për Taksat, Ekonominë dhe Ligjin
4.	Program Ministror 2013, GSMA Mobile World Congress	GSMA
5.	Takimi i katërt i Komitetit të Stabilizim-Asocimit	KSA
6.	Forumi i 7-të i Rregullimit të Telekomunikacioneve	IIR Telecoms & Technology
7.	Trajnim "Aplikime Praktike mbi Menaxhimin dhe Monitorimin e Spektrit"	USTTI
8.	Konferenca e 8-të Ndërkombëtare e ICTA "Sektori i Komunikimeve Elektronike: Sot & në të Ardhmen"	ICTA
9.	Seminar trajnues mbi rregullimin e spektrit	ICTA
10.	Takim i grupit rajonal të punës të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore	ANCOM
11.	Workshop i përdoruesve të sistemeve të monitorimit të spektrit ARGUS	Rohde & Schwarz
12.	Seminar trajnues mbi rregullimin e rrjeteve të aksesit të së ardhmes (NGA)	Cullen International
13.	Forumi eGov	Autoriteti i Zhvill të Komun. të Singaporit
14.	Simpozium Europë 2020: Kalimi në Dividendin Dixhital – sigurimi i aksesit të barabartë ndaj internetit me shpejtësi të lartë	Public Policy Exchange
15.	Simpozium Global për Rregullatorët GSR13 dhe Dialogu Global Rregullatorë-Industri	ITU
16.	Trajnim mbi Strukturimin dhe Negociimin e Marrëveshjeve Ligjore për Koncesionet dhe Kontratat e Shoqërive Publike-Private	IP3

17.	Takim i Panelit Civio-Ushtarak të NATO-s për Menaxhimin e Spektrit të Frekuencave	Këshilli i Atlantikut Verior
18.	Workshop i nivelit të lartë mbi Aspektet Rregullatore dhe Ekonomike të Roaming	ITU
19.	Konferencë Ndërkombëtare “Mbrojtja e Interesave të Përdoruesve të Komunikimeve Elektronike”	EKIP + ITU
20.	Program trajnimi Rregullator Master Class mbi Numeracionin, Portabilitetin, Emrat dhe Adresat	ICC
21.	Kurs trajnimi mbi Protokollin Diplomatik Ndërkombëtar	EuroProtocol
22.	Trajnim mbi Zbatimin e Masave Anti-Korrupsion për Përmirësimin e Transparencës dhe Llogaridhënies së Qeverisë	IP3
23.	Seminar “Testimi & Matjet dhe Teknologjitë OST”	IBIS-Instruments
24.	Trajnim mbi Rregullimin Ekonomik	ICC
25.	Forum i projektit të Komisionit Evropian mbi monitorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit në vendet në zhvillim	Cullen International
26.	Seminar trajnues mbi rregullimin e teknologjive të informacionit	ICTA
27.	Kurs trajnimi <i>online</i> « Gjenerata 4G dhe e ardhmja e Internetit »	ITU

## **II**

### **PROGRAMI VJETOR I PUNËS PËR VITIN NË VAZHDIM**

Programi i punës së AKEP-it për vitin 2014, ndikohet nga nevoja e tregut, kuadri i politikave kombëtare për sektorin, kërkesat e ligjit 9918, të ndryshuar, rekomandimeve të raport-progresit të BE-së për Shqipërinë si dhe Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e AKEP.

Për vitin 2014, AKEP do të punojë me prioritet për:

- Hartimin e projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimi të Spektrit të Frekuencave mbi bazën e Dokumentit të përgatitur nga ekspertët e ITU për këtë qëllim.
- Kryerjen e studimit, hartimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT), si dhe dhënien e të drejtave të përdorimit sipas procedurës.
- Kryerjen e studimit mbi mënyrën dhe kushtet e përdorimit të brezave të frekuencave 900/1800 MHz, hartimin e dokumentit për këshillim publik, si dhe realizimin e procesit sipas procedurës.
- Zhvillimin e mëtejshëm të Projektit ATLAS.
- Analizën e tregut të telefonisë celulare.
- Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë.
- Zbatimin e strukturës dhe organikës së re të AKEP të miratuar nga Kuvendi.
- Përmirësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator.

### **III**

## **RAPORTI PËR STATUSIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL**



Siç është raportuar edhe në Raportin e vitit të mëparshëm, AKEP gjatë vitit 2012 zhvilloi një sërë takimesh me operatorët kryesorë në lidhje me Implementimin e Shërbimit Universal (SHU) në Shqipëri dhe në Nëntor 2012 zhvilloi një konsultim publik për SHU. Konkluzionet paraprake të dokumentit të konsultimit u publikuan në [faqen e internetit](#) të AKEP-it, dhe i'u prezantuan operatorëve në një seminar në dhjetor 2012.

AKEP më 28.06.2013, publikoi [Vendimin](#) nr.2324, për miratimin e dokumentit mbi '[Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 i Shërbimit Universal](#)'. Ky dokument përmban konkluzionet kryesore të mëposhtme:

- Aksesit në shërbimin publik telefonik nga vendndodhje fikse përfshin gjithashtu shërbimet e telefonisë fikse të ofruara nga GSM fiks; tregu plotëson në masë të konsiderueshme nevojat e përdoruesve për këtë element të detyrimit të SHU (kryesisht për shkak të mbulimit të lartë prej 99.8% të popullsisë më sinjal celular) dhe prandaj detyrimi që aksesit dhe shërbimi nga vendndodhje fikse "të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit kudo në territorin e vendit, me një çmim të përballueshëm" është i realizuar dhe nuk ka nevojë për të përcaktuar një ofrues të SHU për këtë element. AKEP do të koordinojë, inkurajojë, kërkojë një ose disa operatorëve të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike që nuk kanë mbulim me shërbim telefonik, por jashtë skemës së SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi në vitin 2016.
- Aksesit broadband nuk duhet të jetë pjesë e SHU akoma, për shkak të penetrimit të ulët dhe mosplotësisë të rregullit 50/80 të rekomandimit të KE.
- Në Shqipëri nuk ka numëror telefonik apo shërbim të kërkimit të informacionit në numëror. AKEP do të ndërmarrë masa rregullatore për të lehtësuar dhe për të promovuar një zgjidhje të tregut për këto elemente të SHU në periudhë afat-shkurtër deri afat-mesme, dhe do të rishikojë statusin e këtij elementi në vitin 2016.
- Telefonat publikë me pagesë: ky element i SHU nuk duhet të përcaktohet pasi një përcaktim i tillë nuk do të ishte proporcional për shkak të rënies së përdorimit dhe rëndësisë së tyre. Nëse është e përshtatshme, AKEP do të koordinojë, inkurajojë një ose më shumë operatorë që të ofrojnë telefona publikë me pagesë në vende të veçanta, por jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në vitin 2016.
- Përdoruesit me aftësi të kufizuara: Qeveria Shqiptare ofron subvencion mujor prej 1000 lekë për përdorues me aftësi të kufizuara dhe nga tregu ofrohen disa masa për këta përdorues. Subvencioni mujor i QSH në kombinim me iniciativat e sektorit privat aktualisht plotësojnë në masë të ndjeshme nevojat e përdoruesve për këtë element të SHU. AKEP do të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në vitin 2016.
- Periudha e përcaktimit për ofrues të SHU duhet të jetë 5 vjet.

Puna e AKEP në vitin 2012 dhe fillimin e vitit 2013 për SHU u bazua në bashkëpunimin dhe asistencën e dhënë nga Banka Botërore në 2012. Bashkëpunimi ishte në kuadër të fazës I të Asistencës teknike të BB (PPIAF) dhe gjatë vitit 2013 u bashkëpunua për fillimin e fazës II të projektit, duke u përgatitur edhe TOR. Faza II e Projektit ende nuk është miratuar/pritet miratimi ose përgjigje në javët në vijim. Ndërkohë, AKEP është duke punuar për përgatitjen e legjislacionit sekondar për SHU dhe masave për promovimin e zgjidhjeve të tregut për numërorin dhe shërbimet e kërkimit të informacionit në numëror në Shqipëri. Faza II e Projektit nuk u miratua nga BB dhe AKEP është duke punuar me kapacitetet e veta për përgatitjen e legjislacionit sekondar për SHU dhe masave për promovimin e zgjidhjeve të tregut për numërorin dhe shërbimet e kërkimit të informacionit në numëror në Shqipëri.

## **IV**

# **RAPORTIMI PËR REALIZIMIN E TREGUESVE FINANCIARË VJETOR**

Me Vendimin nr.90 të Këshillit të Ministrave, datë 06.02.2013 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2013 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 273,300,000 lekë .

Performanca e treguesve ekonomik – financiarë të AKEP – it është e pasqyruar si më poshtë:

<b>Nr.R en</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Programi</b>	<b>Realizimi</b>
<b>I</b>	<b>Të ardhurat gjithsej:</b>	<b>273,300,000</b>	<b>279,566,368</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>273,300,000</b>	<b>193,771,751</b>
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	75,500,000	64,780,771
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	10,500,000	8,862,985
3	Shpenzimet për materiale	5,800,000	4,215,314
4	Shpenzimet për shërbime	48,000,000	36,089,731
5	Shpenzimet për investime	133,500,000	<b>79,808,919</b>
III	Tarifa e Shërbimit të radiokomunikacionit		<b>303,485,096</b>
1	Arkëtuar dhe Transferuar në Buxhetin e Shtetit		<b>303,485,096</b>

### **1. Realizimi i arkëtimeve**

Për vitin 2013, të ardhurat janë realizuar në shumën 279,566,368 lekë nga 273,300,000 lekë të planifikuar në fillim të vitit, me një tejkalim në masën 102.3%. Arkëtimet për vitin 2013 janë realizuar nga pagesat e sipërmarrësve që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike , shërbimeve postare dhe regjistrim domain. Pagesat që llogariten dhe kryhen në AKEP nga sipërmarrësit janë sipas VKM Nr.599, datë 23.07.2010 “ Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP”.

Të ardhurat në AKEP janë përfituar nga pagesat:

- Për dhënie dhe përdorimin e frekuencave,
- Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
- Për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas nenit 24 të Ligjit Nr. 9918,
- Për ofrimin e shërbimeve postare,
- Për regjistrim domain.al
- Të tjera ( çertifikata radio operator, certifikata miratim tipi, radioamator, interesa bankare).

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve që kanë si ndaj AKEP-it, ashtu dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit. Procesi i mbledhjes së detyrimeve nga sipërmarrësit debitor është ndjekur nëpërmjet:

- Dërgimit të shkresave zytare, kontaktimit me telefoni dhe nëpërmjet website.
- Inspektimit të kryer nga Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit.

## **2. Realizimi i shpenzimeve.**

Shpenzimet gjithësej janë realizuar në shumën 193,771,751 lekë nga 273,300,000 lekë të planifikuara në fillim ose në përqindje realizimi është në masën 70.9%. Mos realizimi i shpenzimeve vjen si rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve në disa zëra të shpenzimeve administrative dhe investimeve.

### ***2.1. Shpenzimet administrative***

- Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për material dhe për shërbime janë realizuar në shumën 113,962,832 lekë nga 139,800,000 lekë të planifikuar ose 81.50%.

#### **➤ *Shpenzime për paga dhe shtesa***

Shpenzime për paga e shtesa nga 75,500,000 lekë të planifikuar u realizuan 64,780,771 lekë ose 85.8%. Mos realizimi në krahasim me planin ka ardhur për faktin se shpenzimet për paga e shtesa në fillim të vitit ishte planifikuar për 70 punonjës nga 60 që kishte në organikë në fund të vitit 2012. Shtesa e punonjësve nuk u realizua gjatë vitit 2013, pasi nuk u miratua organika e re.

#### **➤ *Shpenzime për sigurime shoqërore***

Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga 10,500,000 lekë të planifikuara janë realizuar 8,862,985 lekë ose 84.4%. Në mosrealizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore ka ndikuar mos miratimi i shtesës së numrit të punonjësve gjatë vitit 2013.

#### **➤ *Shpenzime për materiale***

Shpenzimet materiale për vitin 2013 janë realizuar në shumën 4,215,314 lekë, nga 5,800,000 lekë të programuara ose 72.6% me një mos realizim në shumën 1,584,686 lekë. Mos realizimi i shpenzimeve materiale në krahasim me programin vjen nga mos realizimi i shpenzimeve për kancelari për shumën 411,893 lekë, nga mos realizimi i shpenzimeve për bojë printeri e fotokopje për shumën 83,673 lekë, nga mos realizimi i shpenzimeve për karburant për shumën 675,002 lekë, nga mos realizimi i shpenzimeve për goma e bateri për shumën 109,800 lekë si dhe nga mos realizimi i shpenzimeve për materiale pastrimi e shpenzimeve të tjera në shumën 307,807 lekë. Në mos realizimin e shpenzimeve për kancelari dhe bojë printeri e fotokopje ka influencuar blerja e tyre me çmime më të ulta se çmimet e programuara. Shpenzimet për karburant në krahasim me planifikimin janë me kursim në shumën 675,002 lekë e cila ka ardhur nga përdorimi më i mirë i levizjes mjeteve si dhe blerja e karburantit me çmim më të ulët se programimi në fillim të vitit.

#### **➤ *Shpenzime për shërbime***

Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 36,089,126 lekë nga 48,000,000 lekë të programuar ose 75.18% me një mos realizim në shumën 11,910,874 lekë. Nga analiza e shpenzimeve për shërbime rezulton se mos realizimi më i madh është në zërin e shpenzimeve për marrjen e ambjenteve me qera për personelin në shumën 3,423,660 lekë, shpenzimeve për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike programeve dhe internet në shumën 2,233,297 lekë, shpenzimeve për auto- transportin për shumën 936,176 lekë, shpenzimeve për

publikime dhe njoftime për shumën 1,001,905 lekë, shpenzimeve për shërbime bazë për shumën 1,173,104 lekë, të shpenzimeve social – kulturore dhe pritje - përcellje për shumën 738,190 lekë dhe të shpenzimeve Të Tjera për shumën 694,334 lekë. Për vitin 2013 edhe shpenzime udhëtim e dieta dhe kualifikim stafi rezulton me kursim në shumën 2,217,289 lekë.

- Në vitin 2013 ishte programuar marrja e ambjenteve me qera për personelin në fillim të vitit, sepse parashikohej të fillohej ndërtimi i godinës së re dhe të zhvendosej personeli nga godinës ekzistuese në ambjente me qera, e cila në fakt u realizua në muajt Prill dhe Maj ndërsa shpenzimeve për qira ishin të proramuar nga muajt Janr 2013.
- Shpenzimet për auto – transportin nuk u realizuan sepse nuk u bë siguracioni kasko e njëjës nga Qëndrat e lëvizëshme të monitorimit dhe nuk u realizuan shpenzimet e programura për mirëmbajtjes së mjeteve të transportit.
- Shpenzimet për mirëmbajtje të paisjeve kompjuterike dhe internet nuk u realizua sepse shpenzimet e programuara të internetit për DNS nga prokurimit i fondit të shpenzimeve për interne rezultuan me ulje për 70%. Nuk u realizuan shpenzimet për blerjen e rekomandimeve dhe raportin e DVD- ROM dhe shpenzime për blerjen e Standarteve ETSI- EDS DVD A,B,C në shumën 280,000 leke. Nuk u realizuan shpenzimet për blerjen e Licencës vjetore antivirus e tjera.
- Shpenzimet për shërbime bazë nuk u realizuan si rezultat i mos realizimit të shpenzimeve të programuara për telefoninë fikse, celulare dhe shpenzimeve për energji elektrike. Në mos realizimin e shpenzimeve për energji elektrike ka influencuar dhe kalimi i paisjeve të DSN në ambjente me qira.
- Nuk u realizuan dhe shpenzimet për udhëtim e djeta dhe kualifikim stafi, shpenzimet social kulturore dhe pritje përcellje si dhe shpenzime e tjera.

## **2.2 Investimet**

Shpenzime për investime për vitin 2013 nga 133,500,000 lekë të planifikuar janë realizuar në shumën 79,808,919 Lekë ose 59.8%. Mos realizimi i shpenzimeve për investimeve për shumën 53,691,081 lekë ka ardhur nga realizimi i procedurave të prokurimit të investimeve nën fondet e prokuruar për shumën 10,687,081 lekë ose 8% dhe nga mos realizimi i disa objekteve investimi në shumën 43,004.000 lekë ose 32.2%. Realizimi i shpenzimeve sipas objekteve të investimit është si më poshtë vijon:

Mirëmbajtja vjetore e “Portabilitetit të Numrit” nga 25,380,000 lekë e planifikuar për vitin 2013 është realizuar në shumën 25,300,500 lekë. Është kontratë në vazhdim nga viti 2011 dhe shërbimi i mirëmbajtjes.

- Konsulencë ndërkombëtare për Ndarjen e Llogarive dhe Sistemin e mbajtjes së llogarive (Account Separation/Cos accounting- AS/CA) për operatorët me FNT nga 16,920,000 lekë e planifikuar është realizuar në shumën 14,001,919 lekë.
- Blerje “Disastar Recovery Site” e planifikuara në shumën 16,920,000 lekë është financuar në shumën 9,968,404 lekë dhe është në vazhdim për vitin 2014.
- Zhvillim dhe suport për FRED dhe rregjistrat të DNS e planifikuar në shumën 5,500,000 lekë është financuar në shumën 2,304,000 lekë dhe është në vazhdim për vitin 2014.
- Ngritjen dhe instalimin e një linje komunikimi për ankesat e pajtimtarëve e planifikuar në shumën 6,500,000 lekë u realizua në shumën 6,360,000 lekë.

- Sistemi IT sigurie dhe monitorimi për DNS dhe rrjetin e AKEP-it me shumën 7,776,000 lekë e cila është kontratë në vazhdimësi nga viti 2012 , u realizua në shumën 7,776,000 lekë.
- Blerje e disa programeve ARGUS (software) për Njësinë e Lëvizshme të Monitorimit e planifikuar në shumën 3,000,000 lekë u realizua në shumën 2,996,281 lekë.
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit Atlas e planifikuar në shumën 2,450,000 lekë është realizuar në shumën 2,450,000 lekë.
- Blerje analizator spektri për monitorimin e frekuencave e planifikuar në shumën 2,100,000 lekë është realizuar në shumën 1,761,600 lekë.
- Upgrade i storage të NP e planifikuar në shumën 1,128,000 lekë është realizuar në shumën 1,006,092 lekë.
- Sistemi i aplikimit të përdoruesve e planifikuar në shumën 451,000 lekë është realizuar në shumën 450,000 lekë.
- Fortinate e planifikur me shumën 425,000 lekë është realizuar në shumën 420,000 lekë.
- Zenoss Network analizë e planifikuar në shumën 423,000 lekë është realizuar në shumën 420,000 lekë
- Softwer për aplikacione për Autorizime e planifikuar në shumën 423,000 lekë u realizua në shumën 350,000 lekë.
- Blerje pajisje zyre e planifikuar në shumën 2,000,000 lekë u realizua në shumën 1,889,090 lekë.
- Blerje laptop - pc e planifikuar në shumën 800,000 lekë u realizua në shumën 699,824 lekë.
- Blerje aparate telefonike celulare e planifikuar në shumën 480,000 lekë u realizua në shumën 292,800 lekë.
- Blerje Printer/ skaner e planifikuar në shumën 140,000 lekë u realizua në shumën 135,600 lekë.

Nga plani i shpenzimeve per vitin 2013 nuk u realizuan objektet e mëposhtëme:

- Dixhitalizimi i Arkivës së AKEP-it e planifikuar në shumën 6,000,000 lekë nuk u realizua sepse procedura e prokurimit për prokurimin e fondit nuk ishte e suksesshme.
- Ndërtimi i godinës së AKEP-it për vitin 2013 është programuar në shumën 29,872,000 lekë. Ky fond u planifikua të mbulojë një pjesë të ndërtimit të godinës e cila ishte planifikuar të realizohej gjatë vitit 2013 pas marrjes së lejes së ndërtimit nga Bashkia e Tiranës dhe lidhjes së kontratës me firmën ndërtuese. Nuk u realizua sepse nuk u miratua leja e ndërtimit nga Bashkia e qytetit të Tiranës.
- Blerja e shërbimit të informacionit rregullator në shumën 10,000 euro ose 1,420,000 lekë nuk u realizua në vitin 2013.
- Pajisje Sigurie Komunikimi në Rrjet në shumën 677,000 lekë.
- Upgrade e sistemit informativ të AKEP e planifikuar në shumën 3061.000 lekë u prokurua në vitin 2013 në shumën 2,801,760 lekë. Objekti nuk u realizua në vitin 2013 por vazhdon në vitin 2014.
- Sistemi Inteligent i mbrotjes për sistemin DSN e planifikuar në shumën 1,974,000 lekë vazhdon për vitin 2014.

### **3. Mbi tepricën e të ardhurave**

Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2013 rezulton në shumën 85,794,617 lekë e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të ardhurave në shumën 6,266,368 lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve në shumën 79,528,249 lekë. Teprica e të ardhurave do të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 3-mujorit të parë të vitit 2014.

### **4. Mbi taksën e radiokomunikacionit**

Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “ Për taksat kombëtare” dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave Nr.28, datë 06.10.2008 “ Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Për vitin 2013 janë arkëtuar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit shuma prej 303,485,096 lekë.

AKEP ka punuar dhe ndjekur në vazhdimësi mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, ka bashkëpunuar me organet tatimore, për arkëtimet dhe derdhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Në realizimin e detyrës si agjent tatimor AKEP ka përfituar komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit në shumën 15,174,254 lekë.

### **5. Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP**

AKEP gjatë vitit 2013 ka punuar për rritjen e performancës dhe efektivitetin e realizimit të treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare duke bërë:

- Kontabilizimin në kohë të veprimeve të arkës, bankës, magazinës për të ardhurat dhe shpenzimet që kryen institucioni.
- Mbyllja e bilancit financiar të vitit 2012 , dhe dërgimin e tij brenda afateve ligjore në organet tatimore.
- Ndjekja e vazhdueshme e sipërmarrësve debitor për likuidimin e pagesave për AKEP dhe tarifën e radiokomunikacionit dhe bashkëpunim me organet tatimore.
- Informatizimi i llogaritjeve të pagesave dhe mundësimi on-line në faqen e internetit të AKEP, për sipërmarrësit me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e debitorëve.
- Inventarizimin e pasurisë së AKEP për materialet në magazinë e në përdorim dhe për materialet e papërdorshme dhe asgjësimin e tyre konform legjislacionit në fuqi.